

Çesk Gjoni


NË RRUGËN «ÇIMISKO»  
TË SELANIKUT

TREGIME

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

734-32

g. 92



është një nga ato që mbahen mend për thatësirë e përi pluhur. Pluhur në rrugët me kaldrëm e sidomos në rrugicat e ngushta të Selanikut, ku nuk ka arritur ende asfalti. Rrugës zbresin barinj të Pindit dhe të Thesalisë me tufat përpara, që shkojnë drej thertoreve. Barinjtë me brucat e leshta, në këtë pisk vase duket sikur e nxehin edhe më shumë këtë kohë, që djeg e u përcëllon buzët kalimtarëve. Njérin ndofta e mundon më fort etja e ai është i huaj. I huaji dallon në vendin e tjetrit nga hapi i pasigurt që hedh, nga vështrimi me të cilin do të shohë dhe të përfshijë çdo gjë, nga vetmia që e rrethon ngado që shkon. Vetëm! Dyqanet e bukura të Selanikut nga hyjnë e dalin blerës, zëri i shitësve, zhurmat e shumëllojshme të rrugëve nuk janë përtë. Pastaj ai nuk e ka mendjen aty, e ka larg, te ai

## NË RRUGËN «ÇIMISKO» TË SELANIKUT

vendi i tij, të cilin qe shtrënguar ta linte dhe të ikte në dhe të huaj.

«*Në kurbet.  
O vajmedet!  
Humb vatanin,  
Humb një jetë...»*

Kështu thoshte ajo kënga që nuk i ndahej nga mendja atë ditë dhe që e përsëriste me vete për ta pasur si shok me kë të fliste në atë rrugë të Selanikut. Këngë ishte e trishtuar, dita ishte e trishtuar, megjithëse ndriste një diell e hapej një quell i kaltër e i pastër si asnjeherë. Trishtimi i tij ishte mali për vendin e tij dhe jo më tepër. Hasan Prishtina nuk ishte nga ata që e lëshojnë veten, nuk kishte qenë nga ata që rrëzohen. Në jetën e tij nuk kishte pasur rrëzim... Kishte pasur trazira, përlleshje, mërzi, gëzime të befta dhe luftë e shpresë. Një jetë e gjallë në luftë... Po ajo kënga që nuk i shqitej nga mendja e përmallonte atë ditë e i digjite sa digjite ai dielli sipër kokës. Krahërin plagë! Shpirtin plagë! Zemrën të lënduar nga merakù për vëndin e të parëve të lënë tutje... Ç'bëhej në Shqipëri? Sundonte dhe shtypte Zogu... Kushedi kur do ta shihet vendin! Ai nuk do të kthehet t'i shtrinte dorën satrapit, as të pranonte gradë dhe ofiqë... Ai ishte Hasan Prishtina dhe Hasan Prishtinë kishte për të mbetur!

Nëpër rrugë jehoi zëri i bozaxhiut. Bozë dhe limonatë si një kohë, në bata ibrikët e bakërt që ishin një trashëgim türk, në rrugët e Selanikut që po modernizohej. I erdhë t'i thërriste atij bozaxhiu, se po i plasnin buzët nga etja, po prapë e la. Ai i

kujtonte vitet e egra të Stambollit, bozaxhinctë në rrugën e parlamentit, që therrisin e përlesheshin njëri me tjetrin kush t'u shiste një gotë bozë deputetëve që u ishte tharë goja nga të hakërriturit atje brenda. Edhe ai kishte pirë në derë të parlamentit e pinin ndofta të gjithë, me përjashtim të dinjitarëve kryesorë, të cilëve bosaxhinctë u rrinin larg. I erdhë parasysh ajo kohë kur ai nuk pyeste nga dilte fjala e nuk pyeste nga dilte plumbi kur ishte në të mirë të shqipërisë.

... Qylafë e çallma turke në atë sallën e vjetër të parlamentit, që nuk kishte ndërruar shumë nga koha e sulltanëve më të tërbuar të Turqisë, vetëm se kishte veshur përsipër një cohë gjoja evropiane. Ai ishte ndier, me të hyrë atje, si një nga deputetët që do t'i sillte ngatërresa këtij mexhilisi të vjetër, që kishte qenë gjithnjë duhaxhi i sulltanëve. Jo vetëm ai, po gjithë deputetët shqiptarë. Hasan Prishtinës i kujtohet si e shanë Ismail Qemalin në mes të të gjithëve dhe si e fyen më tej... Ai pat nxjerrë koburen pér të. Kishte qenë kryekërcyer dhe tani, ndërsa ecte nëpér rrugët e Selanikut, nuk pendohej aspak që kishte vepruar ashtu në atë kohë. I kishte thirrur në dyluftim ata që tērboheshin kundër Shqipërisë dhe shanin shqiptarët. Gazetat turke flisnin me zemërim pér këtë deputet kokëngjeshur, që guxonë të mbante një qëndrim të tillë në Turqi. Kundër kujt ngrihej ai? Kundër Turqisë? Po a e dinte ç'ishte Turqia? Shqipëria nuk do të rronte dot një ditë pa hirin e Turqisë mëmë!

Nuk kishte dashur të mbajë festën e turqve në parlament dhe as të flasë turqisht. I vjen e gjallë ndër veshë thirrja e deputetëve, ajo britma e tyre e potershme pér t'i prerë fjalën.

— *Turqisht! Turqisht!*

— *Nuk e marrim vesh atë gjuhë arnautësh!*

— Kám me vete përkthyesin! — I ishte përgjigjur Hasan Prishtina.

— *Ajo gjuhë arnauti na fyen...*

Ky kishte qenë kryeministri, një njeri që Hasan Prishtina e krahasonte gjithnjë me një farë zvarraniku, se mbështetë fort pas tryezës e madje nganjëherë i mbyllte sytë e sikur e zinte gjumi, I hapte i trembur nga duartrokitjet, ose kur salla gumëzhinte nga të bërtiturat dhe mundohej t'u vinte fre deputetëve, që merrnin e jepnin me gjuhë e me duar.

— Shqipja nuk fyen... Është gjuhë e një populli, siç është turqishtja gjuhë e një populli. Është një gjuhë trimash! Trimi kurrë nuk fyen. Shumë-shumë gjuha jonë mund të jetë e ashpër, por ashpërsia na shkon ne shqiptarëvë, sepse na kanë trajtuar e na trajtojnë me ashpërsi...

Hasan Prishtina fliste dhe ndiqte me vëmëndje përkthyesin, atë burrë në moshë, që përpiquej t'u jepte fjalëve atë theks të fortë që u jepte fjalëve shqip Hasan Prishtina. Ai i përkthente fjalët, po nuk arrinte t'i ngjasë deputetit shqiptar në atë zjarrin që i shpérthente pas çdo fjale. Po kjo nuk kishte rëndësi. Ishte Hasan Prishtina aty. Përkthyesi thoshte fjalët e tij, ato i dëgjonin deputetët nga ai, ndërsa për të parë shihnin Hasan Prishtinen.

— C'kërkoni ju shqiptarët?

Oh, sa, herë është bërë kjo pyetje? Sa herë e kanë dëgjuar veshët e plakur dhe tërë ankth të deputetëve turq! Sa herë e kanë dëgjuar ato mure të trasha! Me qindra vjet është përsëritur ajo! Përpjekja shqiptare ka qenë një shqetësim që e kishte munduar çdo çast perandorinë, hap pas hapi! Hasan

Prishtina kishte dëgjuar njëherë se njëri nga udhëheqësit e shtetit turk kishte thënë: «Arnautllëku na ka nxjerrë aq ngatérresa sa më mirë tē mos e kishim pushtuar para pesë shekujsh. Jo tē mos e kishim pushtuar po edhe t'i kishim dhënë diçka nga tokat tona veç tē qetë tē na linte...»

Një fjalë goje! Një shaka prej tē mëdhenjsh që duan tē tregohen tē zgjuar!

Parlamenti kishte një histori tē gjatë e ajo zgjatej tērkuzë nē ato mbledhjet që nuk bënin gjë tjetër veç ndiznin gjakrat e njerëzve. Deputetët shqiptarë e ndienin veten më tē fortë, se pas tyre ishte kryengritja e Shqipërisë. Atij që kërkonte ta zvogëlonë atë, Hasan Prishtina i kujtonte aty për aty emrat e Hafëz pashës, Mahmut pashës dhe Dervish pashës, që ishin mbuluar me turp nē Veriun shqiptar.

— Q'kërkoni ju shqiptarët, pra?!

— Mëvetësinë!

Deputetët turq dhe kryeministri marrin një pamje prej tē habituri, pamjen e njeriut tē çuditur, që pyet se mos ka tē bëjë me ndonjë tē çmendur. «Pse, a nuk e kanë mëvetësinë shqiptarët? — pyesin ata me vete. — Ky milet gjithnjë ka qenë më vete! Kur i kemi marrë një grosh na ka vajtur buza prapa! Kur i kemi marrë një nizam, ne e kemi ditur sa kemi vuajtur! Kur i kemi vënë një ligj, ne e kemi ditur ç'kemi hequr! Arnautllëku ka qenë fatkeqësia e Turqisë dhe asgjë tjetër!»

Zgjaten orët dhe ditët e mbledhjeve tē parlamentit e tē gjithëve u duket se ato i zgjasin deputetët shqiptarë. Çdo gjë duhet tē ketë një fund, çdo gjëje i duhet gjetur fundi dhe kryeministri turk mendon se ia gjen fundin edhe Hasan Prishtinës. Ndof-

ta e mbyll gojën po ta bëjnë ministër... Eh, çfarë shakaje! Eh, si shpërthen Hasan Prishtina pas kësaj shakaje... Po kush i ngjet sot atij kryeministrit të fjetur turk? Zogu! Ahmet Zogu, që shtiret sikur të ofron një karrike dhe të ofron një plumb... Zogu, po Zogu nuk rri ashtu i përgjumur si ai! I mban sytë katër! Është si një shpend grabitqar...

Zëri i bozaxhiut... I kujtohet ajo ditë në të dalë të parlamentit. Një bozaxhi i mjerë pret te dera të shesë diçka. Ai lutet me gotën e bozës në dorë. E shtyjnë rojet e ai lufton të shesë bozën, pa pyetur për talljet dhe të sharat.

— Arnaut! — ia bën dikush dhe tregon bozaxhiun me gisht.

Hasan Prishtina nuk e lë të kalojë deputetin turk. E shtrëngon fort për krahu dhe e ndal në vend.

— Arnaut je ti? — e pyet bozaxhiun.

— Jo! — ia bën tjetri dhe tund kokën me frikë...

— Dëgjon, efendi? Ky nuk është arnaut! Arnautët nuk katandisen kështu! — i thotë me të ash-për Hasan Prishtinë turkut dhe i lëshon krahun.

Ecën rrugës dhe nuk e di pse i duket se dikush e ndjek hap për hap. Kthehet dhe sheh një njeri të çalë me njërin sy të lidhur, që ka ndaluar në një anë e bën të ndezë cigaren. Ecën tutje dhe e harron atë njeri, që nuk i sjell ndër mend asgjë. Shtyhet në-për ato rrugicat me pluhur të Selanikut dhe shkund rrrobet nga një makinë që ecën me vërtik dhe e bën rrugën mjegull. I duket se shkund pluhurin nga kujtimet e tij e sjell në jetë ata njerëz dhe ato ngjarje që e ngritën në këmbë Shqipérinë. Rri ngjitur me Bajram Currin dhe i anikohet se ia hoqën mandatin e deputetit.

— Ty ta hoqën, popullit nuk ia heqin dot!

Eshtë maji i vitit 1912. Behar, të nxehjtë si kë-të ditë!.. Një të nxehjtë shqiptar që lind nga krisma dhe nga duhma e pushkëve të kryengritjes së madhe. Mbushur Juniku me qeleshe të bardha, e ato janë shpresë e Shqipërisë!

— Kallaballëk i madh, o bacë!

— Erdhën të provojnë gishtin e pushkës!

Bajram Curri e ka çuditur gjithnjë. Ajo qetësia e tij e fuste në mendime Hasan Prishtinën. Shpesh ai thoshte me vete se qetësia e bacës ishte siguria për të ardhmen e vendit të tyre.

— Folju një fjalë, bre Hasan, se ti je i fjalës.

Hasan Prishtina ngrihet, por mendon se sa punë bën ai me të folur, po aq bën edhe Bajram Curri me të heshtur. Plaku kishte një heshtje që fliste thellë, thellë. Populli ishte mësuar me atë gjuhën e tij të heshtjes. Bajram Curri thoshte një fjalë, dhe aq mjaftonte. Kjo fjalë çonte përparrë mijërat e malësorëve, që nuk pyesnin ku e kishte çerdhen vdekja...

— Shqiptarë! A na shtron ari i botës?

— Paj besa, kurrë jo!

— A ta lypim lirinë?

— Jo, sa të jenë diell e hanë!

— Kah t'ia mbajmë?

— Pushkën tunkut!

— A na mund mënia e armikut?

— Kurrë, për këtë besë që ka shqiptari!

— Atëherë pushkën, pra!

— Ulet përbri Bajram Currit dhe e sheh me bisht të syrit. Kishte folur ndër parlamente të huaja, kishte folur me prijës të huaj e me njerëz të posteve të larta dhe kurrë nuk ishte druajtur se mos kishte gabuar. Para Bajram Currit druhej... Mustaqet e bukurë të plakut sikur shkëlqejnë nga një gjëzim, që i

është hapur në tërë fytyrën, dhe Hasan Prishtina qetësohet. Nuk ka gabuar dhe ka folur si duhet. I ndrit fytyra bacsës...

— Të lumtë goja, bre Hasan!... Bilbili këndon në të ri, ti ke për të mbetë bilbil edhe në pleqëri...

Bajram Curri ngrihet e pastaj nuk shkon shumë dhe ia nisin pushikët. Ato krismat i kujtojnë se Bajram Curri nuk rron më dhe ai trishtohet prapë. E vruai ai, ai... Në rrezik të madh kishte qenë edhe vetë e mezi kishte shpëtarë në Shkëlzen, në Bradashnicë dhe në Thep të Gjolve... 14 xhandarë pas Hasan Prishtinës, që duan ta çojnë gjallë a vdekur ndër këmbët e mbretit. 14 xhandarë që turren andej nga strehohet Hasan Prishtina dhe nuhasin zjarret e shuara nëpër shpella.

C'moshë kanë ato zjarre? C'kohë u ndezën? Xhandarët janë kokëtrashë dhe nuk mund të llogarisin gjér aty ku shtyhen zjarret e kryengritësve shqiptarë... Zjarret janë tepër të vjetra për xhandarët që i numërojnë ditët me gishta... Hasan Prishtinë e kërkojnë shpellave, atë e mban populli në konak! E kërkojnë në konak e ai e gdhin ditën në shpellë... Kapërcen shtëpi më shtëpi e fis më fis...

— A ti je Hasan Prishtina?

— Hasan Prishtina më thonë! — kaq i duhet për të kapërcyer shtëpi më shtëpi e fis më fis. Me këtë emër ai mund të kapércejë gjithë Shqipërinë e t'u ikë xhandarëve të Zogut... Kapërcen shtëpi më shtëpi, po ajo që lë prapa nxjerr tym. Kapërcen fis më fis, po fisi që lë prapa shkretohet... Hasan Prishtina e sheh që duhet të shkojë në dhe të huaj. Populli e mbrojti pa marrë parasysh shkatërrimin e vet, po ai nuk do ta shkatërrojë popullin. Do të vijë dita që do të kthehet, dhe atëherë nuk dô të ketë dert se e dëm-

ton popullin. Atëherë do të fillojë lufta kundër tiranit.

Ai i çali e ndjek prapë. E ndjek apo i bëhet Hasan Prishtinës? Do të kishte shkuar pa i kushtuar vëmendje sikur të mos i kujtohej që ai ishte i vëshur me një setër të trashë, apo një farë palltoje. Pallto në pisk të vapës?! I bëhet se tre të tjerë rrinë pas çalamanit dhe duket se kanë të bëjnë me të. Dyshon, po megjithatë ndalon kur i thërret çalamani.

— Si je Hasan Prishtina?

«Qenka shqiptar! Sa mirë!...»

— Të paçim, burrë! Si je?

— Hoqa keq të të gjej...

— Hajërlı, pér çfarë? — pyet Hasani i habitur.

— Pér të të lënë një porosi: «Shqipëria po të pret!» Kështu më thanë kur u nisa.

— Sa të jetë Ahmet Zogu, nuk kam vend në Shqipëri!

Tjetri kafshoi buzën e buza sa nuk iu përgjak.

— Pse e kafshon buzën, o byrazer?

— Syri... Erdha ta shëroj këtu, po m'u bë më keq... Ja, shihe....

Hasan Prishtina nuk luajti, po pa që tjetri u afroa. U afrua dhe ngriti atë shkopin që pat në dorë...

— Ej, ej... — ia bëri Hasan Prishtina pa marrë vesh ç'donte me atë shkop ai njeri. Kaq tha. Pastaj ndjeu të shtime me armë dhe një therje të fortë pas shpine. Nuk u rrëzua, po shkoi duke u mbështetur pas avllive gjer te një mur që e vishte shemasheku. I hodhi një sy të turbullt rrugës nga po ikninata që kishin qëlluar mbi të dhe pa çalamanin që hiqte lidhësen e zezë nga syri. Përpëliti sytë me një rënkim të lehtë dhe tha:

— O nënë! Mos më harro!

— E kishte me Shqipërinë, dhe ajo kurrë nuk e harroi...

## GJARPĒRI I UNORIT

— Mirash! Bajraktari ta ka vënë synë...  
— È di!

Mirashi dhe Prela... Argatët! Mirashi është mbështetur pas sfurkut dhe vështron Prelën plak në sy. Mirashi është rrogtar i ri, Prela i ka punuar të jatit të bajraktarit. Mirashi fërkon kallot e duarve pas bishtit të sfurkut. Janë kallo të reja, po ato djegin si djegin ato të Prelës. Kanë ndarë frymën bashkë. Kanë ndarë djersën e bukës dhe poshtërimin. Poshtërimin?

— Kështu kanë qenë brez pas brezi këta... I ati, gjyshi i tij! Nuk ka si del ndryshe dhe Ukë bajraktari...

— O Prelë! Poshtërimin nuk do ta ndajmë bashkë! O do ta mbaj mbi sup e më humbtë mortja përgjallë, o do të dal me ballë të bardhë... Nuk e merr

time motër bajraktari! As me hatër, as me pahir! E ka një grua në konak! Për grua të dytë plumbin!

— A kishe pér të bërë krushqi me derën e tij?

— Kurrë pér të gjallë, edhe sikur të ishte beqar! Jemi gjindje e vogël e duam gjakun e shpirtin tonë...

Rrinin në plevicë e jashtë binte borë. Plevica kundërmonte erë bari të thatë dhe erën e plehut që kishte nisur të trashej nënë këmbët e bagëtive. Tutje vinte pëllitja e lopëve të bajraktarit, një pëllitje e ngopur dhe e dembelosur, si ajo e të zotit kur posa ngrihej nga sofa. Ato kafshë nuk do të ngordhnin nga uria, do ta nxirrnin dimrin si jo më mirë.

— Po qe se nuk rresht bora, lopa nuk më del në pranverë e fëmijët nuk më dalin në pranverë, — tha Prela.

Malësori u kthye nga Mirashi dhe e pa në sy.

— Kur të ikësh ti kam pér të mbetur kërcu...

Kështu ishte. Mirashi e dinte që plaku do ta kërkonte. Në atë rrethin e njerëzve të kullës së bajraktarit vetëm ata të dy merreshin vesh njëri me tjetrin. E Mirashi priste të errej dhe të ikte. I zoti i kullës ishte i pabesë. Plumbi, thika, helmi ishin një gjë e zakonshme pér Ukë bajraktarin. Prandaj Mirashi binte natën në shtresa dhe nuk e dinte a do të zgjohet. Flinin me Prelën në një kthinen poshtë kullës, në një hardallinë të vjetër nga dukej dielli në verë dhe vareshin hejtë e akullit në dimër. «O Prelë! Kur ma ka nda dekikun?» Prela nuk dinte ç'ti thoshte. Mbulohej përsipër me gunganë e vjetër dhe njërin sy e mbante hapur... «O Prelë! A më ka ardhë dekiku?» Mirashi ishte hallexhi si gjithë të varfrit që dalin e kërkojnë dheun pér të

fituar bukën e kishte shpresuar se bajraktari do të hiqte dorë nga e motra. Në një anë e mbante kjo shpresë, në tjetrën i druhej Ukë bajraktarit.

— Kush ia shtini në vesh time motër, Prelë?

— Keqan Gjeta e Keqan Gjetën e ka futur të të vrasë! Kur të mos jesh ti e ëka rrugën pasqyrë për në kullën tënde...

Prelës i dhimbsej Mirashi. Djalë i pashëm, i drejtë, punëtor...

Nuk do ta shikonte më Mirashin! Do të ikte malit e mali kushedi ku e nxirrte.... Do të ikte një pjesë nga zemra e tij! Do të ikte mish nga mishi i tij! Do të ikte gjak nga gjaku i tij. Gjithë të varfrit kishin një mish, një zemër e një gjak...

Mirashi pret të erret, që të mos bjerë në sy. Mendon për bajraktarin dhe Keqan Gjetën, atë cub që e mban Uka pas vetes dhe e lëshon revan pas gjahut... Mirashi do të rrojë... Kërkon të rrojë

Eshtë i ri...

Akoma mjekra s'i ka dalë...

Akoma faqja s'i eshtë rrudhë...

Akoma syri s'i eshtë mpakë...

Akoma zemra s'i ka bulëzuar...

— Poshtërimi eshtë plehu i shpirtit, o Prelë, e vorri për së gjalli! Në vorr do të hyj për së vdekuni, kur të më vijë vakti, e Keqan Gjetën, namin e zi të maleve, do ta fus në vorr para vaktit!

Dredh drita e bie hëna mbi mal e mbi borë. Mirashi ndahet me Prelën e merr malin. «Nuk e kisha provuar jetën e kaçakut e duhet ta mësoj, o Prelë! Thonë eshtë e bukur... Thonë eshtë e ash-për... «Le të jetë si të jetë, se unë po e bëj për ndërin tim e të maleve!» Kështu ndahet me Prelën e as i dridhet mjekra, as i pikon loti, as i shkon ndër

mend që ka lënë të motrën vetëm në konak me një plakë që e ka kaluar lisin më të moçëm të bjeshkëve...

Bie borë e re e rrugët zihen në gjumin e hesh-tur të dimrit. Bie borë e Mirashi nuk fle, vrri në vrri e bjeshkë në bjeshkë. Kërkon Keqan Gjetën e Keqan Gjeta kërkon atë. Cubi emrin e ka cub, se ndejën e bukën e gjumin i bën te Uka bajraktar. Emrin e ka cub, po malet nuk i kërkon si Mirashi... E ka emrin cub, po dredh duhan ballë për ballë me Ukën bajraktar... Vjen një kohë që dimri zgjatet shumë dhe Uka bajraktar nis e mërzitet. Mirashi në mal i pret rrugën e asaj çike që e ka fort për zemër e do ta marrë në konak mbi gruan. Dikush e ka py-etur si do t'i thotë priftit... «Priftit? Do t'i nxjerr bu-tin e rakisë e shpatullën e derrit. Kjo është fjala e parë! Do t'i them se e marr rrrogta-re si marr burrat e malësisë. Kjo është fjala e dytë! Do t'i vë pu-shkën nënë hundë, po bëri naze. Kjo është fjala e tretë!» Keqan Gjeta sheh se syri i bajraktarit ësh-të veshur me mjegull dhe del nga dera me pushkë në dorë. O vjen me kokën e Mirashit, o vjen pa ko-kën e vet! Nuk vjen as Mirashi, as Keqani! Vjen zë-ri i një morti, që nuk merret vesh morti i kujt është. Pastrohet jehona e maleve, e atëherë shkrep më shkrep:

- Ohoho! C'është pushka, more?
- Ohoho! Kuj iu tha votra, more?
- Kanë vrarë Keqan Keqin!
- Ja puthsha grykën e pushkës, more!
- Kush e vrou, more!
- Mortja e vet e të zezat që u ka punuar ma-leve, more!

Bajraktari rri e dëgjon si i dehur. Kur i doli

Keqani nga kulla, iu duk se lëshoi langoin për lepuj. Ashtu ishte vjedhur ai, si duke u mbajtur pas mureve, që mos t'i binte në erë as bajraktari. Langojtë e gjuetisë ia kishin sjellur gjithnjë gjahun te dera. Keqan Gjeta solli mortin e vet. Bajraktari mendon e mendon... Mendja e tij është si një pus i errët që e ndriçon vetëm gjaku... E ndriçon vetëm ëndrra për hakmarrje... E ndriçon dëshira për motrën e Mirashit... A i shkon i vëllai motrës në kullë? A lahet e ndërrohet? A merr bukën e javës e duhanin e muajit? Dikush i thotë se njeriu bredh e bredh nëpër shokë e miq, po lidhet për hu të kullës së vet në fund të fundit! Nuk ka derman pa shkuar te kulla e vet! Aty ia vë priten bajraktari. Vjen një lis me degë... Bajraktari syrin në thepin e pushkës. Vjen një ah me trungun sa nuk e përfshin burri. Bajraktari syrin në thepin e pushkës... Vjen një djalë pa qime në faqe e bajraktari zbraz pushkën! Mo, t'u thafshin krahët, se thave lulen e djalit!

Uka ikën me vrap. Vrapon e ndalet në kullë. Çakairët e ri e qeleshja i janë bërë pis me baltë. Fytyrën e ka dyll, si dylli i bletëve, e kaq është i trembur e i habitur sa nuk është në gjendje të mbledhë veten dhe të shijojë gëzimin. Ai Mirashi iu duk se i ndenji në këmbë dhe nuk e rrëzoi plumbi::.

Pastaj ai Prela që e mallkon vetëtimthi:

— O, t'u thafshin krahët! O, e paske vrarë!

Urdhëroi Uka:

— Pastroma tytën dhe hidhi vaj!

— Zotni! Kjo pushkë nuk ma pat zërin e mirë...

— Çiftja e gjuetarit nuk e ka krismën të ëmbël...

Prela i merr erë grykës dhe tund kokën. I zoti i ka thënë se dikush tjeter kishte shtirë në egër-sirat e malit.

— Pushka jote paska duhmë baroti...

— E shkrepë diku në përrua, — zbehet bajraktari.

— A vrave gjë?

— Një rosak të ri... Rosa nuk më ra në dorë, po dita e gjahut zgjat sa zgjat dimri e ka pér të më ra në dorë... Rosaku ishte aq i ri, sa nuk bën as ta rjepësh, se të mbeten puplat në dorë... — Tani bajraktari e ka mbledhur dhe e ndien gëzimin e gjahut që ka bërë.

Prela vetëtimthi vetë me vete: «Si nuk ka një plumb kjo pushkë! Një plumb qorr të kishte! Një plumb të ngrënë vitesh dhe të ndryshkur! Nuk do plumb tjeter mortja e bajraktarit! Oh, t'u thaftëjeta, o t'u thaftë, se thave lulen e djalit!»

Nga gishti i Prelës nuk drodhi plumbi... Nga sytë e Prelës drodhën lotët.... Oh, t'u thaftë e zenza zemër, bajraktar!

— A të kam gjë borxh, o bajraktar?

— Jetën! Kurrë nuk lahesht me borxh me të parin e vendit, o Prelë! Çfarë mendjeje ke?

— Të kam borxh belin, sfurkun e sopatën, o bajraktar! Ato po t'i sjell...

Prela i sjell belin, sfurkun dhe lopatën dhe kris e ikën nëpër natë larg e më larg bajraktarit... Prapa ndien zérin e tij: «O Prelë! Më ke borxh jetën!» po Prela nuk do t'ia dijë kur nuk desh të dijë Mirashi pér jetën e vet!» Ai do të ikë të tregojë mal më mal pér bajraktarin dhe do të ngrejë ven-



din kündër tij. Do t'u hapë sytë malësorëve të unorit dhe të unorëve të tjerë rrëth e rrrotull. Gjithë katundet kanë bajraktarin e tyre...

Bora ka zënë të tretet e bagëtitë mezi kanë dalë nga dimri. Ky është çasti më i rëndë i tufave... Kur nuk është as dimër, kur nuk është as pranverë... Dikush i shtrin dorën bajraktarit për një grusht bar e ai e kthen prapa atë dorë, ose e merr me gjithë bagëti. Fati i keq e ka mbuluar unorin! Unori paska lindur pa fat në fajqe të dheut e nuk ka pse rrон. Bajraktari ka dale gjallë e shëndoshë nga dimri. Ka vetëm një mërzi, Prelën që mbledh njerëz kundër tij e i ka mbushur malet më kaçakë. Ka një mërzi tjetërsoj, dhe ajo është mërzia e Tringës, motrës së Mirashit. Ajo nuk na qenka më Tringë. Ajo na qenka veshur burrë!

Hyn në kullë të saj dhe i duket gjallë Mirashi. Mirashi në vend! A nuk iu duk se nuk i luajti nga vendi kur i shtiu me pushkë në gjoks? A nuk iu duk se rrinte gjallë dhe e ndiqte prapa tek kthente bishtin nga kulla e vet?

Bajraktari zë e luan me Tringën si macja me miun... Kulla vetëm. E errët... Bosh. Tringa në këmbë para tij e arma tej në gozhdë. Bajraktari e ka një dyshim të vogël. Si nuk po i trembet syri kësaj çike me çakçir? «E ka ulë kokën, — ngushëllohet bajraktari. — E di se në dorën time se në dorën time është».

— O, Mirash! Të erdhë në konak!

— E pashë se hyre, o bajraktar!

— Zérin e ke të ëmbël e mos e dridh si zë gjarpri, se nuk të shkon! Nuk të ka kafshuar gjarpri dhe mishin e ke të ëmbël, — tha me një nënqeshje dinake bajraktari.

— Dhëmbin e gjarprit e kam gjer në kockë, o bajraktar...

Tjetri e sheh dhe e sheh. Gjaku i hip në kokë nga bukuria e kësaj çike të veshur si burrë. Rrobet e burrit sikur i paskan dhënë nur tjetër, më të ashpër, më të sertë, më të dëshiruar për Ukën bajraktar. Ai bën një hap përpara dhe afrohet buzë votrës dhe aty shtrihet. Maja e pushkës së gjatë është varur sipër kokës së tij e bajraktari është i sigurt. Ai është trupplogët dhe duket si një thes në postiqen e votrës. Ai ndien se i ka ardhur dita, se po i vjen dita, dhe kërkon që ajo të zbardhë avash-avash, që ta shijojë më mirë. Zë e përcmon e ngacmon unorasit.

— Sa bagëti ka në unor?

— Një stan, dhe ai i shkretuar...

— Sa kripë?

— Një dorë e më pak se një dorë...

— Po tokë?

— Nuk e kalon pëllëmbën...

— Ta kam falur unorin? — tha bajraktari.

— Nuk falet haku i tjetërkuj, o bajraktar!

E ka syrin pishë dhe mendjen pishë. Mendja i rreh ku t'ia rrasë plumbin bajraktarit... Ku i dhemb më shumë? Ku i dhimbti të vëllait? Ajo e kishte gjetur pa jetë dhe nuk dinte të thoshte ku i kishte dhembur më shumë të vëllait...

Bajraktari e çik tytën e pushkës me kokë dhe nuk mendon më asgjë të keqe. Vazhdon të keqen me gojë:

— Thonë se qenka veshur një çikë si burrë në katund tonë, o Mirash!

— Kështu ka qenë zakon, kur mbetej shtëpia pa mashkull, o bajraktar!

— Gjynah! Ka qenë vajzë me e pi në gotë të rakisë! Ah! Më kishte një bel sa unaza e gishtit e gishti nuk të hynte në të! Edhe ti bel unaze më ke, o Mirash!

Mirashi shikon me inat.

Uka vazhdon si përpëra:

— Trupi i saj posi pisha e drejtë! Kështu ma ke trupin edhe ti, o Mirash!

— Shoh se më ngjaka fort, o bajraktar...

— Bash si me ia pas këputë kokën!

— Të kisha lindur vajzë do të isha si ajo! Linda burrë, o Ukë bajraktari!

Hahen sy në sy dhe hetojnë njëri-tjetrin. Bajraktari se si zë e shqetësohet, po pastaj thotë me vete prapë se nuk është gjë.

— A ka ndonjë hak me marrë ajo vajzë që është veshur burrë? — pyet bajraktari.

— Hakun e të vëllait!

— I vëllai shkoi gjakhumbur, se nuk i dihet gjakësi...

— I dihet, o bajraktar!

— Kush është? — dridhet tjetri.

Nuk merr përgjigje hë pér hë. Ka para vetes një burrë që mendon me një fytyrë të zymtë si nata:

«Bajraktari është cub, o kullat e unorit! Bajraktari është tmerr, o njerëzit e unorit! Bajraktari të ka vrarë vëllanë, o Tringa e unorit! Alltia të zbardh faqen, o Tringa e unorit!».

Kështu mendon dhe alltia i zbardh faqen... Vret armikun e të gjithëve.

Që shqipëria që ka qenë e përgjithshme është përfundim i këtij  
kohë që ka qenë e përgjithshme. Përveç se që është e vlefshme që  
nuk ka qenë e përgjithshme, nuk ka qenë e vlefshme që është e  
vlefshme. Nuk ka qenë e vlefshme që është e vlefshme. Nuk ka qenë e  
vlefshme që është e vlefshme. Nuk ka qenë e vlefshme që është e vlefshme.  
**AMANETI I PARTIZANIT**

Rrija në një qoshe dhe shihja dom Injacin me  
atë Pashukun, që i kishin sjellë për t'i gjykuar në  
fshat. Priftin e kisha gati përballë, po nuk e nde-  
shja dot vështrimin e tij, se i mbante sytë përdhe.  
Deshalbe ta shoh njëherë në bebe të syrit, deshalbe ta  
shoh si i dridhej bebja e syrit... E merrja me mend  
gjersa i dridhej trupi, merrja me mend se ashtu  
duhej t'i tronditeshin edhe sytë, po sesi më ishte  
tekur ta shoh aty... Këtu e 30 vjet përpëra ia kis-  
ha shumë frikë ata sy të turbullt e të vegjël, që  
i lëvizte shpejt e shpejt nëpër gropëza e pastaj i  
mekte si i dehur. Në këtë çast më fishkëllonte një  
shputë e fortë pas veshit dhe e shihja veten tutje  
pas murit. Kur ngrihesha në këmbë, më digjte faqja  
dhe më dhimbte fort koka nga përplasja. Prifti nuk  
ma falte që kisha thyer njëherë padashur një idhull  
porcelani të shën Mërisë. Kisha jonë kishte qenë e  
vogël dhe nuk kishte asnje orendi ose zbukurim, veç

një krishti të kryqëzuar në mur dhe atij idhulli të shën Mërisë, që rrinte aty mbi atë altarin prej druri të gdhendur keq, ku prifti çonte meshën. Prej asaj dite që theva idhullin nuk pat kurrë paq përmua dhe prifti më rrihte ku të më zinte. Më parë e shihja rrallë nëpër rrugët e fshatit, po që kur më zuri belaja me atë shën Marinë, ai më dilte ku nuk e prisja. E di si shkoja rrugës? Si ai që ruhet nga qentë! I bëja sytë katër dhe kokën e sillja rrotull si të ishte diçka që kthehet nga të duash. Më kishte futur tmerrin! Më dilte në udhë dhe unë ngrijë. I ikja babait e vëllait të madh, kur kisha bërë ndonjë prapësirë, e nuk kthehesha gjer në mbrëmje vonë në shtëpi e shpëtoja pa u rrahur. Prifti më gozhdon-te në vend me ata sytë e tij të turbullt e nuk isha në gjendje të bëj një hap pa ngrënë dackat e tij. Ndofta ma kishte fajin nëna e gjyshja, që më tremb-nin me ferrin dhe më thoshin se duhet t'i bindesha dom Injacit si zotit! «Mjaft më, o padre, të paçim! — i thoshin fshatarët që donin të më shpëtonin nga ai. — Mjaft më! Edhe qoftëlargu të ishte do të qe shpaguar gjer tani!» Unë nuk u shpago-va kurrë me dom Injacin dhe atë nuk mund ta harroj. Tani, që e shoh këtu me sytë përdhe, më bie ndër mend që ai kishte një fytyrë të butë e të ëmbël me fshatarët, kishte një zë të mekur e të dhembshur kur predikonte, po të gjitha këto ndry-shonin kur më dilte përpëra dhe më rrihte. Ndryshonin këto edhe kur vinte të kërkonte hakun e kishës dhe të merrte paret e atyre që u bënte shërbimet e fundit. Tani e sjell ndër mend që prifti nuk ndryshonte në këto raste nga bakalli që kishim në fshat, nga ai Selimi me sy çakërr, që numëronte paratë pas banakut me një sy dhe tjetrin e mbante

nga ne, që rrnim te dera. Derri i derrit! Na vidhte  
në kandar e na vidhte haptas. Oka e tij nuk ishte  
okë e kripa e tij nuk ishte kripë! Për sheqerin nuk  
di ç'të them, se ne atëherë nuk kishim para për she-  
quer... Bakalli na vidhte në peshë e na e shtrenjton-  
te mallin, prifti e shtrenjtonte hakun e  
kishës! Tani mendoj që prifti e bënte si  
s'ka më mirë punën e bakallit dhe bakalli mund  
ta bënte si jo më mirë punën e tij! Ai më rrahu e  
më rrahu sa mban moti i gjatë, po njëherë m'u  
mbush mendja dhe qëndrova. Atëherë që qëndrova  
më rrahu im atë... Ja, sikur e shoh priftin, atë ditë  
që qëndrova... Ai më afrohet, më afrohet... Unë ki-  
sha me kohë diçka në mendje dhe ia shkrepë në  
fytyrë:

*Dom Injaci  
Kokë tullaci!  
M'i ke faqet,  
Si mullaqet!*

U hutua, u zbe dhe shoga e tij e rrumbullakët  
sikur u bë e bardhë nga zemërimi dhe të hutuarit.  
Kurrë nuk e kishte pritur këtë gjë nga një fëmijë  
që e kishte rrahur një vit të térë! Nuk kaloi shu-  
më dhe e pasqë të vijë drejt meje me atë veladonin  
që ia merrte era kur ecte me të shpejtë dhe kur  
zemërohej. U ula dhe rrëmbeva një gur. Sa vjeç  
isha atëherë? Dhjetë, njëmbëdhjetë ndofta, po gurin  
e rrëmbeva si burrë! Aha! Dikërka të kthejë shpi-  
nën edhe dom Injaci! Aha! E njihka frikën! Prifti  
ik e unë pas tij, me gurin në dorë dhe duke thirrur  
si i marrë nga gjëzimi:

*«Dom Injac,  
Kokë tullac...»*

Kështu gjer në kishë, po brenda nuk ma mbajti të futem. Në darkë më rrahu aq keq im atë, sa ndenja tri ditë në shtrat. Po nuk më erdhi fare keq, se gjithë fëmijët e fshatit e kishin mësuar bejten time për dom Injacin. Unë isha shumë krenar për ato katër vargje, të cilat nuk do t'i ndërrroja me asgjë, në botë. Ç'ndodhi pastaj? Pastaj erdh clirimi dhe dom Injaci u bë i butë, i butë...

— Sot do të heqim qafe dy ferra... — më pësh-përiti dikush te veshi, po unë nuk e pashtë kush ishte ai që rrinte pranë meje. Nuk ia ndaja vështrimin dëm Injacit, që nuk i kishte ngritur asnjëherë sytë.

— Dora e priftit e dogj njérën nga stallat...

Tani kthehem dhe e vështroj atë që më flet. Eshtë xha Marku dhe, kur flet ai unë, nuk dyshoj për asgjë. Kështu duhet të ishte gjersa fliste xha Marku dhe kështu ishte gjersa prifti, me atë Passhukun ndodheshin në bankën e të akuzuarve. Njëra nga stallat ishte djegur para katër muajsh dhe do të digjel edhe tjetra po të mos ishin kooperativistët. Roja e natës ishte munduar dhe nuk kishte arritur ta shuante zjarrin. Dikush kishte hedhur një bishtë cigareje në të ngrysur... Ja lanë fajin rojes! Apo nuk tymoste ajo pipa e tij si furra e gëlqerës! Ai kundërmonte nga duhani dhjetë hapa larg! Apo nuk m'i kishte ata mustaqet e dendurët të verdha sikur t'u kishte rënë sarillëku! Ia lanë dhe nuk ia lanë fajin rojes! Mbet pezull disa javë djegia e stallës, gjersa u kap prifti. Askush nuk kishte thënë së ai e kishte djegur stallën, po kur e panë në bankën e të akuzuarit atëherë të gjithë e besuan se ai e kishte vënë zjarrin! U erdh madje

inat që nuk u kishte rënë ndér mend menjéherë pér dom Injacin:

— Ngrihuni, i pandehur!

Dom Injaci ngrihet dhe tregon si e ka djegur stallën.. Ja, me ndihmën e atij Pashukut... Pashuku eshtë një thatim e një i mbrapshtë, që të vret systë ta shohësh. Nip kulaku, dajën e ka pasur me bandat, gjersa mbet në një qoshe pylli. Një vëlla në burg pér vjedhje. Pashuku e ka kallëzuar priftin... Pashuku ka marrë të holla nga dom Injaci po nuk e ka vënë zjarrin vetëm pér të holla... Ai e urrente këtë jetë, urrente kooperativën, urrente... Fshati nuk kishte menduar në fillim pér dom Injacin, ama pér Pashukun kishte menduar... «Ai e ka vënë zjarrin! Pashuku! Roja e stallave pi duhan si mushku i Ndocit të Marash Ndocit, ama e pi jashtë stallave... Turrjuni Pashukut, se i vjen era blozë...»

— I pandehur! Na thuaj si deshe të arratisesh...

E mbaj mend atë natë. Ishte një natë me shi dhe ujet më hynte në gjizmet e gjata të peshkimit nga mushamaja që më shkonte sa andej këndej nga era. Isha i lodhur dhe i mërzitur... Nuk na kishte ecur gjuetia atë natë. Një ditë më parë nuk dinim ku ta fusnim peshkun, atë natë vetëm na hyri shiu gjer në palcë... Ecja bregut të lumit dhe matanë ishte kufiri. Kur viaj natën këndej, merrja me vete ose fenerin, ose elektrikun e dorës, po atë çast nuk i kisha asnjërin. Ecja nëpër atë terr sa me të futë gishtat në sy dhe shpejtoja të arrija në shtëpi, që të ndërrrohesha. Ai dreq shiu nuk më harrohet... pllaq-plluq, pllaq-plluq, — dëgjoj hapa para meje dhe mezi shquhet një si formë njeriu, që më vjen përballë. Hija rri dhe pret pak hapa larg meje.

Prës dhe unë, Në një shkreptimë hija më duket si prifti, po prapë nuk dua ta besoj që ka dalë jash-të në këtë dreq kohë, Pastaj ai kurrë nuk është shtyrë shumë këndeja.

Ai përballë më përshëndet duke lëvduar Jezu Krishtin dhe mbetet keq kur unë nuk ia kthej për-shëndetjen. E marr vesh që është prifti dhe se ç'më shqetëson përbrenda.

— Asht kah vdes Ndoci i Prekolajve dhe më duhet të shkoj në këtë qamet, — dëgjoj zërin e priftit dhe dicka më shtrëngon në zemër. Ndocrin e Prekolajve e kisha takuar shpesh dhe nuk kishte dy ditë që e kisha parë shëndoshë e mirë.

— Vdekjen e kemi borxh dhe ajo nuk pyet për të shëndoshë e për të rinj, — dëgjoj prapë priftin dhe turbullohem edhe më shumë. Nuk dua të flas me dom Injacin dhe nuk dua të di në po vdes apo nuk po vdes ai burrë i mirë, që kish emër në fshatin fqi. Prifti më kalon përpara me kokën ulur, ja, tamam si rri tani para trupit gjykues, dhe unë bëj të shkoj në shtëpi, po nuk më çojnë këmbët. Se si më vete ndër mend që prifti më foli i pari dhe ndjeu nevojën të thoshte se ku po shkonte. Ai ndof-ta dhe nuk më kishte njobur më terr e në shi. Pse foli atëherë? Ai vidhej dhe se ç'fshihte... Si t'ia bëja? Shtëpinë nuk e kisha larg tanë, po postën e kisha gati gjysmë ore larg. Të hyj në shtëpi, a të vete në postë? Ia mbaj nga posta. Gjej dhe operativin e zonës aty. Para së gjithash i pyes për Ndocrin e Prekolajve... Operativi qesh kur i tregoj si kisha takuar priftin. «Ik në shtëpi dhe ndërrohu, — më thotë. — Ai Ndoci i Prekolajve ka për të ta sje-llë këtu priftin!» «Priftin nuk e kam dajë, që të

ma sjellë mua», i përgjigjem unë dhe marr vesh cdo gjë.

— Ku të zunë, i pandehur?

Ah, ia pashë sytë! Iu drodhën, qenit. Iu drodhën kur iu kujtua si e kishin zënë kur përpiquej të rrëmbente një varkë. Kishte dashur të thyente zinxhirin me të cilin lidhej varka...

— Varkën nuk e ruan zinxhiri, i pandehur! E ruan populli! Nuk e dije ti këtë?

E kishte ditur, po nga do t'ia mbante? Pashuku ishte kapur dhe Pashuku nuk kishte si të mos e kallëzonte. Kishte hedhur zaret! Të dalë ku të dalë!

Dikush tallet nga salla dhe thotë se dom Injaci kishte dashur të shkonte të merrte bekimin e Pa-pës, po ndërhyr kryetari i gjyqit dhe të gjithë heshtin. Tani dom Injaci na ka kthyer shpinën. Mua më duket se trembet më shumë nga ne se sa nga trupi gjykues. Dhe kështu ishte. Githë kohën që do të vazhdojë ky gjyq ai nuk do të guxojë të kthehet nga salla!

— Na ka frikë... — më vjen një tjetër pëshpëri-tje në vesh dhe unë shoh si puqen mendimet e mia me të atij që më rri afër.

— Na ka frikë! — i përgjigjem unë dhe ndiej një kënaqësi të patreguar, që ka ardhur koha që ai njeri i zi të trembet nga populli, të cilin e kishte trembur me vjet e mot. Ai ua di forcën gjyqtarëve që ka përballë, po trembet nga ne, se e di që forca e tyre rrjedh prej nesh, prej popullit. Kështu mendoj me vete dhe ndjek me kureshtje se çfarë thotë prifti. Pas pak do të më duhet edhe mua të dëshmoj si e kam parë priftin atë natë në shi dhe, të them të drejtën, kam një farë turbullimi, se nuk do ta përdrejtën,

shkruaj dot ashtu siç duhet. Po tē mē lejonin, unē do tē flisja mē shumē se pēr atē natē, do t'ia nisja qē nga koha kur kisha thyer idhullin e shën Mērisë.

— Mē tē madhen e kanē lēnē pēr nē fund, — mē thotē nē vesh ai qē kam pranē, dhe unē e shoh qē ai burrē dinte mē shumē se unē rreth kētij gjyqi. Ai vazhdoi tē mē pêshpérinte:

— Atē vrasjen me tē pabesë tē Gjelosh Vuksanit... Nuk paskan qenë fjalë nē erë ato qē pêshpérishim. Po kiske shkuar shumē kohë... Koha e mbuloi, koha e zbuloi...

I rashë me bërryl tē heshtte. Kryetari i gjyqit m'i kiske mbërthyer sytē e po bëhej gati tē mē têriqte vërejtjen. Tani ndihem edhe mē i turbulluar, se diku aty nē sallë kam parë nënën plakë tē Gjelosh Vuksanit. Kthehem dhe e shoh qē rri nē një anë me faqen mbështetur nē njerën dorë e me sytë nga prifti. Pastaj luan nga vendi dhe vjen një radhë pas meje. E mban prapë njérën dorë nē faqe, ndërsa tjetra i dridhet nē supin tim. E ndjek me bisht tē syrit atë dorë tē plakur qē dridhet, atë dorë tē mbledhur grusht, dhe mē bie ndër mend se nē trupin e tē birit kiske imbetur brenda një plumb nga tē armikut, tē cilin nëna e Gjeloshit kërkoi t'ia jepnin. E kisha parë Gjelosh Vuksanin tē vdekur dhe njerëzit tek e qanin, edhe mua mē vinte tē qaja... Mbaj mend qē kiske apo nuk kiske një muaj qē ishte cliruar vendi. Mbaj mend qē erdh shërbëtori i dom Injacit dhe e pyeti zonjën e shtëpisë nëse donte t'i bënte shërbesën fetare tē birit. Mbaj mend qē ajo ia mbylli derën... Ja, ajo qē ka grush-tin nē supin tim...

— I pandehur! Na thuaj si ia kurdise vrasjen Gjelosh Vuksanit.

Dridhet gjithë trupi im dhe unë nuk kujtohem që dridhet dora e plakës që e mban në supin tim. Pastaj dridhet gjithë salla e më duket se ata stolat e drunjjtë kërcasin aq shumë, sa nuk dëgjohet se ç'thotë dom Injaci. Këtë nuk e kisha pritur kurrrë! Nuk e kisha pritur ta gjej vrasësin e Gjelosh Vuksanit te prifti. Ne e dinim që atë e vranë ata banditët e malit. U vranë dhe ata nga forcat e ndjejkjes dhe nga populli dhe gjaku u mbeti atyre. Tani duket isha ngritur në këmbë, prandaj më thërrisin nga të gjitha anët: «Ulu! Ulu!» U ula. Dora e plakës kishte rrëshqitur gjatë kurrizit tim kur isha ngritur e tani e ndieja prapë mbi sup. Ngrita dorën dhe mora dorën e saj mes shuplakave të mia. Ishte e ftohtë akull e unë pata frikë se mos i ndodhë gjë aty. Nuk kishte gjë, vetëm ngrinte. Ngrinte dhe i përshkoheshin të dridhura në ato gishtërimjtë nervozë.

— Nënë! Nënë! — i pëshpërita dhe u mundova t'ia hap grushtin.

Nuk më la. — A —

— Jo! jo!.. — e ndjeva që tha dhe nuk e ngava më. Pastaj nuk e kishte më ashtu të ngrirë atë dorë. Po i ngrohej, «Si duron? Si mbahet kaq mirë? — pyeta me vete dhe ndërkaq më kishin ikur shumë nga ato që kishte thënë dom Injaci.

— Pra, e thirre Gjelosh Vuksanin në qelë, i pandehur?

— Po, zoti kryetar...

— E dehët me alkool?

— Nuk piu, zoti kryetar... Sepse...

— Si iu mbush mendja të vinte në qelë?

— Në mbrëmje kalonte poshtë qelës për në shtëpi të vet. I nxora para Pashukun e ai e ktheu

në rrugë. Unë kisha dyzet kuinalë drithë e qyteti nuk kishte bukë...

— A hyri Gjeloshi në qelë?

— Nuk hyri, zoti kryetar! Nuk i shkonte muhabeti me mua dhe më thirri nga oborri.

— A nuk dyshoi në gjithë këtë zemërgjerësinë tuaj, i pandehur?

— Dyshoi... «Dom Injac, më tha, kurrë nuk ke qenë kaq shpirtgjerë! Megjithatë unë po të them se ke dashur t'i dalësh punës përpara. Këshilli i fshatit do të vinte nesër për punë të drithit te ti. Ai do të vijë nesër e do të vendosë ç'të bëjë me drithin tënd...»

— «Me drithin tënd», i pandehur? Kështu të tha!?

— «Me drithini tonë», tha Gjeloshi, — u përgjigj prifti dhe uli kokën.

— Pse tha ashtu?

Sepse ai gjithnjë thoshte se unë e grabisja fshatin.

— A e grabisje fshatin, i pandehur?

— Përgjigju, i pandehur!

«Na thithë palcën e kockave!» bërtiti dikush nga salla.

Kryetari i gjyqit i ra lehtë tryezës dhe të gjithë heshtën pas asaj zhurme që tërroqi ajo e thirrura kundër priftit.

Dëgjova prokurorin që dha shifra e përmendi vitet e gjata të dom Injacit në fshatin tonë. Megjithëse ato që thoshte ai ishin krejt të sakta, unë prapë se prapë se si mendoja që dom Injacit e kishte rrjepur shumë më tepër popullin.

— Si e vratë Gjelosh Vuksanin?

— Ata të malit ishin brenda dhe shtinë nga dritaret. Pastaj e mëron dhe e lani në përruan përtjej katundit...

Mbaruan me priftin dhe me Pashukun. Folën dishmitarët, midis tyre fola dhe unë. Dihet që nuk munda t'i përmend ato dackat e fëminisë. Kur u ula në vend, dridhesha nga inati e ishte dora e nënës së Gjeloshit që më rrasasi supin...

Ato që dëgjuam nga prokurori tani nuk më bënin më përshtypje, se dom Injaci ishte zbuluar i téri para meje. Përpara se të kërkonte dënimin e priftit, prokurori u kthyte nga populli, sikur të pyeste popullin çfarë dënim i duhej dhënë dom Injacit. Atëherë ndjeva që luajti plaka pas meje dhe pashë dorën e saj të shtrirë të hapur. Në pëllëmbë mbante plumbin e të birit. Ai plumb kaloi rresht pas rrështi gjer te trupi gjyques...

...përfshirë qëdoq që i është obët i Amerikës. Një johas u kthe i një shtëpi eshte i përmendur i njëjse tjetër që e ka veshur. Veshur i kësaj veshje nuk është vërtetë. Nëpërmjet kësaj veshje e mësimdhënuesve është shumë të mira. Përmirësohet veshja e tij. Të paktën, që e rregulltohet që veshja e një mësimdhënuesit të është e veshur si veshja e një përgjigje së cilës. Por nuk ka qenë kështu. Në vërtetë, veshja e tij është vërtetë e veshur, që e ka veshur. Me çili që e veshur? S'ka qenë veshja e një mësimdhënuesit, por veshja e një mësimdhënuesit nuk është veshja e tij. Në vërtetë, veshja e tij është veshja e një studente. Nëpërmjet veshjes së tij, studentja ka veshur veshja e tij, që është veshja e një mësimdhënuesit. Nëpërmjet veshjes së tij, studentja ka veshur veshja e tij, që është veshja e një studente. Nëpërmjet veshjes së tij, studentja ka veshur veshja e tij, që është veshja e një studente. Nëpërmjet veshjes së tij, studentja ka veshur veshja e tij, që është veshja e një studente. Nëpërmjet veshjes së tij, studentja ka veshur veshja e tij, që është veshja e një studente.

po tani që nuk mund të marrë vëllat e kështu  
mësuar, që iu bënë përditësimin e lirët. Në këtë  
mbajtje mund të bëj vëllat e kështu që iu  
dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
që iu dëshironin, që iu dëshironin, që iu dëshironin,  
**DITËT E NJOHJES**

«Ai të do dhe... Dhe ti je një copë budallaqe!»  
më tha Liza mbrëmë dhe iku andej nga fjetoret.  
Unë ndenja një copë herë në mensë duke i mbajtur  
gozhdë në kokë ato që tha ajo. Mëri nuk i mbajta,  
se nuk mund t'i mbaje mëri për asgjë Lizës. Të tho-  
shte diçka në vesh dhe ia mbathë me të katra. Të  
ngacmonte dhe ec e zëje... Kështu e kishte Liza.  
«Hë, malësoret e mia? M'i keni bërë sytë katër! Po  
u dalin vendit! Po i hani të gjallë këta djemtë e ak-  
sionit! Asnjë nuk do të shpëtojë nga ju». «Malëso-  
re je dhe ti», mundoheshim ta vinim përpara ne».«Unë?  
Unë vetëm bëj shaka... Kush llap shumë, nuk  
gjen burrë...» Kështu ishte në të vërtetë. Fliste pa  
pushuar dhe nuk pyeste me cilin fliste. E kishte  
njobur tjetrin një ditë përpara, apo një orë përpa-  
ra, për Lizën ishte njëlloj. Ne e donim, se fliste pa

të keq, ngacmonte pa të keq. Pa të do të ishim gjetur disi ngushtë ato ditët e para kur erdhëm në aksion dhe nuk njihnim njeri. Fjetoren e kishim të mirë, të pastër, shtretërit të rinj e dyshekët të posashtruar. Mbi to nuk kishte rënë njeri para nesh, e megjithatë Liza do të gjente një shkak për të thirrur ata që drejtonin në kamp që të shtonin edhe diçka në fjetoren tonë. Të gjithë ata që sillte i quante «përgjegjës, shoku përgjegjës» dhe ata vinin e për çudi bëheshin copë për të vënë një palë perde të reja në dritare, apo për të gjetur fotografi me pamje nga deti, sic i donte Liza. «Shoku përgjegjës! Jemi të malit, ne! Nuk kemi det!» Tani mendoj se të gjithë ata që përpinqeshin ta bënin sa më të bukur fjetoren tonë, nuk e bënin vetëm për Lizën, po për të gjitha ne! Tani mendoj se nuk do ta kishim aspak ngushtë edhe pa Lizën dhe do t'ia dilnim në krye edhe vetë, po kur e shihnim që ishte aq e gjiltër dhe e afroeshme me të gjithë, nashukej se na kishte çelur dhe afrouar edhe ne.

«E shikon atë? Gjithë sytë mbi ty i mban!»  
Gérmonim malin sa mundnim dhe mali dukej sikur tallej më në. Mali ishte mal dhë ne njerëz, që mezi e gjerivishnim më kazmat dhe lopatat tona. Ishte dita e dytë që punonim për trasenë rrëzë malit dhe minat nuk i kishim parë ende. Kur të nisnin ato, mali do të zvogëlohej në sytë tanë dhe ne do të rriteshim para malit. Po, edhe vetëm me kazmën në dorë do të rriteshim para malit dhe do të ishim më të mëdhaja se ai, vetëm duhet të kalonte pak kohë dhe të shihnim sa trase kishim lënë pas shpine..»  
«E shikon atë? Gjithë sytë mbi ty i mban!»  
Nuk e ngrita as kökën, as sytë. Ishte dita e

dytë që kishim ardhur në akcion dhe askush nuk kishte pasur kohë të më njihje, as të ngulte sytë mbi mua. Pastaj e njihja Lizen, se kisha mbaruar tetëvjeçaren me të e tek fliste më dukej sikur fliste kur mësonim në shkollë. Nuk ishte nga fshati im, po nuk e kisha larg dhe na ndante vetëm një përrua. Unë kisha mbaruar kursin dyvjeçar të infermiereve, ndërsa ajo shkollën e mesme bujqësore. Thoshte se do të shkonte përtë mësuar më tutje, sa t'i vinte i vëllai nga ushtria dhe unë e besoja se do të shkonte.

«Ej, moj! Ej! Me ty e kam!» nuk po më ndahet Liza.

Përkrah nesh punonte brigada e Klosit, një brigadë e fortë, e fortë me djem dhe me vajza, aq të dhënë pas punës, sa nuk ua dëgjuam as zérat ditën e parë e të dytë.

«Ej! Ju shokët pa gjuhë!» u thirri Liza pa pyetur që nuk i kishte injohur kurre. Liza nuk mund të duronte të kishte përkrah njerëz që vetëm gërmorin e gërmorin dhe nuk dinin të flisin një fjalë shoq me shoq. «Po vajzat ku i ken, morë shokë?» Këtë turn ata të Klosit nuk kishin shumë vajza. Ato që kishin ardhur i kishin lënë në fjetoret dhe në mensë. Turnin tjetër kishin ardhur më shumë vajza se djem nga fshati i tyre, po Liza nuk e dinte këtë, dhe nisi të kapej pas këtij bishti. Jo fanatikë, jo prapanikë, jo mbeturinë. Ec e ndale Lizen! Ne ulnim kokat dhë shkuleshim së qeshuri, por kur iu kthyen Lizes ata djemtë e heshtur të Klosit, nuk ndenjëm döt pa i dalur zot, megjithëse e dinim mirë kush e kishte fajin. Po ata djemtë e heshtur të Klosit na paske shin qenë të heshtur, sa t'ia dilnin normës dhe ta kalonin normën,

se pastaj... Pastaj ec e hahu me ta! Vetëm njëri, ai për të cilin më kishte ngacmuar kot së koti Liza, nuk bënte zë dhe vetëm vinte buzën në gaz kur haheshim ne me atë shkak të bukur që gjeti Liza për t'u afruar me ta. Them shkak të bukur tanë, se në fillim na u duk sikur e teproi, sikur e shkeli, si e shkelte ajo shpëshherë pa të keq. Pra, ai as m'i kishte ngulur sytë dhe, me sa dukej, nuk kishte ndër mend të m'i ngulte kurrë ato. As unë nuk desha që ai të merrej me mua; po një gjë nuk po e merrja vesh: si iu tek Lizës të më fliste pikërisht për të? Ai ishte një djale i madh, flokëgështenjë dhe me një fytyrë të gjérë e nofulla të mëdha, që e dallonin prej të gjithëve. Kishte ca sy të butë që sikur binin në kundërshtim me fytyrën e tij të pjekur dhe të rrëshkur nga dielli e nga puna përjashta. Sytë i kishte si të një fëmije, të kâltër e të ëmbël e një dalldisje e lehtë endej në to. Gërmaja dhe hidhja sytë nga ai. Tani isha unë ajo që po e haja me sy dhe Liza do të kishte të drejtë të plotë po të merrej më mua me atë gjuhën e saj gjithë humor. Po ajo nuk e kishte mendjen te unë e unë vazhdova ta vështroj gjatë atë djale, që gërmonte malin me kazmë e kishte ato sytë e butë. E shihja si i tkurreshin muskujt kur ngrinte kazmën, si i tendosej gjithë fytyra e pastaj sikur clirohej nga një mundim i madh kur e ngulte kazmën në shkëmb. «Një njeri që punon pa hile» tha shë me vete dhe qesha, se nuk kisha parë ende ndër ne një njeri që punonte me hile. Po prapë sikur qëndronte ajo që thashë e nisa ta përsëris me vete: «Ai punon pa hile! Pa hile!» Kjo ndodhë ndofta se ai djale kishte një mënyrë të vetën punë e ajo i delte përmbi muskujt e tij, mbi djersën e

mbi atë fytyrë të tendosur që pasqyronte përleshjen me malin. Dita e punës mbaroi dhe unë ngrita kokën padashur nga ai. Jo, ai nuk kishte sy pér mua! E pashë si pastroi kazmën, madje m'u duk se e zgjati me atë të pastruar, pastaj uli kokën dhe vajti pas shokëve që ishin nisur përtet duke ia marrë një këngë aksionesh. Në mensë e kisha përballë dhe e vërejta gjatë gjithë kohës si hante, si e afronte pjatën, si i fshinte buzët me shami, si e ngrinte gotën e ujit, që e kapte sikur të ishte diçka tepër e rëndë. E zinte me gjithë dorën dhe gota humbiste në dorën e tij të madhe. Jo, ai nuk kishte sy pér mua... U zemërova me veten dhe nuk, e vështrova më. As Liza, nuk më ra në qafë pér një kohë të gjatë e unë e harrova atë që më kishte thënë. Puna,jeta në aksion ishin aq të vrullshme, sa një ngjarje ndiqte një tjeter dhe nuk të mbetej kohë të mendoje pér gjëra të tilla si shakatë e Lizës. Po njëherë se si m'u kujtua dhe nuk ndenja pa ia përmendur.

— Pse më the ashtu pér atë nga Klosi?

— Pér Ganiun?

— Pér Ganiun...

— Kot! Ia këputa kot...

— Këto nuk janë gjëra të cilave duhet t'ia këpusësh kot! — u nxeva unë dhe desha të iki.

Liza më mbajti.

— Shiko, shiko! — tha ajo e habitur. — Shiko! — ia bëri edhe një herë dhe iku duke qeshur. Ajo desh të thoshte se shakaja e saj kishte zënë vend te unë dhe se unë kisha menduar pér atë djalin nga Klosi.

Mjaft ditë me radhë nuk i pamë ata të Klosit. Ata punonin tanitë ura e madhe, se aty duheshin

djemtë fortë për betonin. Ndërsa ne zgjatnim dhe zgjatnim trasenë pa fund. Tani e shihnim se mund të haheshim me malin edhe vetëm me kazmat tonë, dhe kjo na gjëzon. Pashdrekeve kishte ditë që binte shi dhe na mbyllte brenda. E kishim zët shiun dhe nuk dinim si ishte e mundur që gjithë paraditen mbante kohë e mirë dhe shkruhej shiu pas punës. Rrinim në fjetore dhe lexonim shtrirë, ose shkonim në klubin tonë të vogël, ku kishte gati për natë diçka në televizor. Në tri-katër ditë do të kishte një mbrëmje, dhe atë e prisnim me padurim. Unë e kisha harruar djalin nga Klosi; ai tani ishte ashtu si gjithë të tjeter përmua, ishte si gjithë djemtë nga Klosi, që i shihja me njëfarë admirimi kur ktheheshin nga ura të zbardhur nga çimentoja. Kështu dukeleshin më të burrëuar dhe ndonjërit i kishin hije ato mustaqet që kishte lënë në aksion. I dukeshin të thinjura e të rënda. Atë e kisha harruar, po Lizën e kisha ndër mend. Mundohesha t'i marr hakun pa të keq, të bëja një shaka me të, ashtu siç bëri ajo me mua, po për dreq asgjë nuk më vinte ndër mend. Nuk isha e shkathët si Liza për këto gjëra.

— Lize, — i thashë një ditë. — Nuk po llap më ashtu si përparrë.

— Po, vërtet, — m'u përgjigj me njëfarë çudie. — Vërtet që jam bërë më e heshtur. Po, mos më hidh mua...

— Nuk dua të të hedh gjë...

— E di si, moj motër? E di që më ka rrëmbyer puna? Të hyka puna në sy dhe nuk të hyka asgjë tjeter. Sa u bënë që kemi ardhur? Një muaj? Kur shkelëm këtu, në fillim, këtë punë që kemi bë-

rë për një muaj nuk besojat bënimi as përnjë vit.

Kështu tha ajo dhe unë e ndjeva që fliste me gjithë zemër. Kështu kishte folur gjithnjë Liza, që kur e njihja unë në atë shkollën tonë tetëvjeçare. Edhe kur bënte shaka kështu fliste ajo.

Nuk e la me aq.

— Ndofta nuk të pëlqen që kam heshtur... Mos do të të flas për atë? — ma mori hakun përnjëherësh Liza.

Unë u skuqa dhe ndjeva se desha të më fliste për atë.

— Ai është djalë i mirë! — tha Liza kësaj here pa shaka.

Unë nuk i dhashë përgjigje.

— Ai është më punëtori...

Unë prapë heshta.

— Ai është...

— Lizë! Ti e paskë njojur goxha...

Sikur e dëgjoj tanë të qeshurën e singertë të Lizës. Një të qeshur me shpirt e me zemër.

— Budallaqe! Unë nuk u hyjnë hak shoqeve! — u tall ajo.

Nuk po e merrjë vesh pse kishë nisur të skuqem dhe kur ndodhë kështu e ndieja vjetë poshtë Lizës. Kur skugesha nuk i bëja dot ballë asaj, dhe ajo e dinte mirë këtë.

— Ai është djalë i mirë, po këto gjëra nuk sajohen vetëm me zemër, po edhe me mendje, — më tha shoqja dhe që atë çast unë e ndjeva tepër të afërt dhe tepër të ngrohtë Lizën. Ajo mori një pamje aq serioze sa më trembi. M'u duk se gjithëjeta imë do të vendosej në atë çast që fliste Liza dhe nuk di pse ndjeva frikë. Më vonë e kujtova këtë

çast dhe u zemërova vetë me vete që isha trembur. Ku kishte fjalë më me mend se ato që më tha Liza?

E di ç'do të bëj? Unë do të të njoh me të... Pastaj... Pastaj hidhe vallen vetë...

— Po që për t'u njohur njihem vetë, — iu përgjigja — dhe m'u duk se e munda atë gjakun e kuq që më ngjitej në fytyrë...

— Ah! Kështu? Kështu është dhe më mirë!

Si i thashë Lizës? Do të njihem vetë me të! Ishte e pamundur të rrinim të veçuar, se na bashkonte puna, mensa, klub. Pastaj dhe as që donim të rrinim të veçuar. Po, njohjes me Ganiun i jepja një kuptim më të ngushtë, e kisha fjalën te shqëria. Një mbrëmje rrinimi në klub dhe shfiletonim gazetat dhe revistat. Televizorin e kishim mbyllur, se shkrepëtintë dhe kishim frikë se na digjej. Ganiun e kisha përballë me një grup djemsh që ndiqnin një lojë shahu. Ai rrinte pa folur dhe nuk i ndihte asnjerit prej atyre që luanin siç ishte zakon në ndeshjet e shahut. Luanin dyvetë, po, në të vërtetë luanin dymbëdhjetë që vështronin përreth! Ai u ngrit e unë kujtova se do të shkonte të flinte, kurr m'u afroa. Atëherë e ndjeva që nuk po e vija dot poshtë atë gjakun tim të kuq, që kurre nuk kisha dëshirë të ngjitej përpjetë.

— Ku e keni atë gjuhëshpatën? — pyeti ai me të qeshur.

Liza ishte dezhur, po muaj m'u duk se ajo ndodhej aty. Ajo ndodhej kudo ku isha unë dhe, me sa dukej, ajo kishte hyrë e dë të hyntë edhe më thellë në jetën time. E mora vesh se edhe Ganiu nisej nga Liza për t'u afroar më mua.

— Eshtë dezhur në mensë, — mezi iu përgjigja tunë.

— Ç'është ajo revistë? — pyeti ai duke u ulur pranë meje.

Ia zgjata revistën:

— Më pëlqen «Shkenca dhejeta». Unë jam traktorist, po kam dëshirë të lexoj. Lexoj dhe vjersha... — se si tha ai sikur të fliste për ndonjë faj të tij.

— Edhe unë lexoj, po jo aq shumë...

— Po ajo gjuhëshpata?

Unë e pashë me vëmendje. Kishte ardhur të fliste me mua, apo kishte ardhur të fliste për Lizen?

— Ajo është vajzë e mirë! — thashë unë, se nuk desha ta thërriste «gjuhëshpatë».

— Ajo është e mirë, po dhe ti je e mirë! — më tha Ganiu dhe u ngrit para se ta mblidhja veten.

Atë natë bëra një gjumë të shqetësuar dhe më përpëlita sa andej këndejej. Atë natë e pashë në endërr të fejuarin tim, që nuk e njihja dhe që nuk e kisha parë kurrë në endërr! Më kishin fejuar fëmijë. Ndofta jo në djep si të tjerat, po fëmijë dy-tre vjetësh. Ajo fejesë u prish, merret vesh, dhi, të them atë që është, babai nuk u treguarkokëfortë. Madje e ndjeva një natë që i tha nënës diçka rrëth fejesës sime të vegjëlisë, diçka që e nderoi tim atë. Ai ishte njeri me katër klasë shkollë, po kishte ditur ta hidhte pas shpinës të vjetrën me t'i dhënë rasti. Dhe rasti ju dha kur u prishën ato fejesat e vegjëlisë. Tani rri e mendoj sa gjë e marrë kishte qenë ajo puna e fejesave në vegjeli, po rri edhe mendoj edhe për veten. Më thoshin se me të mbaruar tetëvjeçaren do të më çonin nuse te ai bu-

ri i panjohur, po unë nuk e di pse nuk e vrisja mendjen për të dhe nuk e besoja se do të bëhesha nuse e një burri të panjohur. Njëherë mbaj mend që erdhi dikush dhe desh fë caktojë ditën e dasmës. Babanë e pashë të mërzitur dhe ai u qetësua vetëm kur iku ai malësori që nuk e kisha parë kurrë në derën tonë. Ndjeva që babai i tha se do të më conte në shkollë dhe se isha ende e vogël për martesë. Ndjeva edhe përgjigjen e atij që kishte ardhur. Dhëndri nuk kishte dert se vajza mësonte apo nuk mësonte! Ai dontë nuse për konak! Nuk e di si u ndanë atë të dy atë natë, po di që babai më thà të nesërmendë bëhesha gati, se do të më conte në kursin dyvjeçar të infermiereve. Pastaj erdhi ajo dita kur nisen të rrëzohen përdhe fejesat pas zakonit dhe mblesërisë. Kaq për të kaluarën time dhe për të fejuarin tim që nuk e njihja! Tani le të kthehem edhe njëherë te ajo natë e shqetësuar që kalova dhe te ato ëndrrat që pashë. E kuptova pse isha rropatur ashtu dhe pse kisha parë ato ëndrra të frikshme. Ndjeja diçka për Ganiun! Kjo ishte! Ndjeja diçka për të dhe kisha frikë se do të ma prishte dikush. Po kush mund të ma prishte? Marrëzira! Unë kisha rënë në dashuri... Po ai? Ai më afrohej përherë e më shumë dhe unë e ndjeja se këtë doja. Doja që ai të vinte të më merrete për të kërcyer, të më priste kur mbaronim turnin, të më sillte një libër, të më fliste për vete dhe për njerëzit e tij, të kënaqej dhe të gëzohej kur isha e gjëzuar unë. Kisha ndodhur e kundërtë e asaj që kisha menduar: nuk kishte qenë ai që më kishte tërhequr vërejtjen, po unë e kisha shtyrë të interesohet për mua. Unë, nga ajo lëdra e Lizës që nuk di si do të mbaronte! Dukej njeri i mirë, njeri në punë të vet,

njeri i dhënë pas punës, gati i harruar pas saj. «Po tē merret kaq shumë me punë, — mendoza, — me mua kur do tē merret, po tē martohem me tē?» Dukej njeri i mirë, po a ishte në tē vërtetë kështu? Kur e njoha unë pér një muaj? Pér një muaj e disa ditë që kishim kaluar bashkë? Njëherë erdhie më thirri në dhomë natën vonë.

— Eja! — më tha. — Mersini ka thyer këmbën. Unë u tremba dhe gati e mbulova kokën nënë batanije. U tremba pér vete dhe pér Mersinin. Nuk isha marrë ndonjëherë me thyerje, pastaj më erdhie shumë keq pér Mersinin.

— Ku e theu kështu në mes tē natës? — nuk iu durua Liza.

— Doli pér tē pire, ujë dhe rrëshqiti...

— Aha... — ia bëri Liza, dhe më pa me një vështrim kuptimplotë.

Desha t'i them tē kthehej, e tē diltë sa tē viresha, po nuk po flisja dot dhe e kisha lënë Ganiun në këmbë si ndonjë guak.

— Prit jashtë! Kjo infermierja jote nuk vjen dot me gjithë batanije! — bëri shaka Liza.

Mersini nuk e kishte thyer këmbën. E kishte përdredhur. Ia ferkova, kerkova një shishe dhe e bëra tē rrotullojë shputën e këmbës sipër saj. Ish shumë e lumtur që ai kishte shpëtuar me aq dhe as që pyesja tani që shtrëngonte dhëmbët dhe kafshonte buzët nga dhembja. Do t'i kalonte. Të ishte thyerje nuk do tē dija çfarë t'i bëja e do tē më duhej ta nisja te mjeku ynë e ai do ta përcillte patjetër pér grafi në qytet. Nuk do tē kishte kushedi ç'rëndësi ky rast po tē mos lidhej me Ganiun. Se sim'u dha ta shoh, ndërsa ia ferkova dhe ia lidhja këmbën shokut tē tij, dhe mbeta. M'u bë sikur mjeko-

já këmbën e tij dhë jo të Mersinit! Aq thellë dhe aq në mënyrë njerëzore kalonte dhembja e shokut te ai, sa unë e humba fare. Erdh një çast që më zu krahët dhe më pengoi t'i ferkoj këmbën Mersinit. Shtrëngonte dhembët Mersini, shtrëngonte krahët e mi Ganiu! «Ky është shpirt njeriu! Ky është njeri i mirë! Njeri i dhembshur», mendova dhe atë natë e ndjeva veten shumë të lumtur. Kisha ardhur në aksion dhe as më kishte shkuar mendja ndonjëherë se do të njihja një njeri më të cilin ndofta do të lidhesha për jetë. Po ja si ndodhi... Punonim rrnim bashkë, lexonim, iknim gjer në qytet dhe nuk i kishim thënë asgjë njëri-tjetrit. Ditët iknin. Erdh dhe ajo mbrëmje kur më shau Liza. Të nesërmen do të niseshim. E kishim mbaruar aksionin. «Ai të do dhe... Dhe ti je një copë budallaqe!» më tha Liza. Dola nga mensa e menduar. Tutje zhdukej silueta e Lizës, që ishte zemërtuar më muaj. Sipas saj unë e kisha tjerrur gjatë. Sipas saj unë i tirrja gjatë punët... A nuk kisha sy? Ganiu ishte pikë e djalit! Këto ishin fjalët e saja përparrë se të më shante. Më shau se unë i përmenda atë që më kishte thënë dikur për dashurinë. Nuk duhej vetëm pasioni po dhe mendja. Pak a shumë kështu mbaja mend se më kishte thënë. Liza m'u tur dhe më tha se Ganiu kishte dhënë prova sa për të marrë yllin e vajzave e jo vetëm një copë infermiere. Ajo kishte besim se ne mund të bënim një çift si duhej. «Ai nuk më ka thënë asgjë», i thashë Lizës përparrë se të më shante. «Si të të thotë? Ti m'i rri si një copë akulli!» U enda një copë herë përmes barakave e kredhur në mendime. Po errej krejt dhe në quell kishte dalë hëna e plotë, që pas pak do ta përfshinte gjithë vendin me

një dritë të zbërdhulët që të ndjell mendime. «Eshtë shpejt...» thashë me vete. Kështu ishte. Sa kishim ndenjur, në aksion nuk mjaftonte për t'u njo-  
tur njëri me tjetrin. Kjo le të ishte njoftja e parë... Po ta donim njëri-tjetrin ashtu si pandehnim të dy, do ta ndiqnim në anë të anës... «Eshtë shpejt!» tha-  
shë edhe një herë më e vendosur se kurrë dhe hyra prapë, në mensë. Nxora një copë letër dhe shkrova adresën time, pastaj i thirra Ganiut dhe ai doli me një peshqir në dorë. U turbullua kur më pa dhe që aq i hutuar, sa nuk dinte ç'të bënte me atë pesh-  
qir.

— Gani! Nesër nisemi...

— Nesër! — tha ai i mërzitur...

— Ti në një anë, unë në tjetren...

— Jo! Jo! — tha ai duke bërë një hap përp-  
ra.

Mua m'u lidh dëcka në fyt dhe gati përsërita si ai: «Jo! Jo!» Më ndihmuani ata djemtë e Klosit që kishin nxjerrë kokën në dritare dhe na shihnin pa të keq. E tèrhoqa Ganiun pér krahу.

— Kjo eshtë adresa imë! — i thashë.

— Adresa?! — ia bëri ai si i hutuar.

— Adresa!

— Ç'ta bëj?!

— Me këtë më gjen mua... — mezi i fola,

Ai ma ktheu copën e letrës,

— Unë të gjej dhe pa të! — më tha gjithë gjë-

zim.

Ika. Ika gati me të shpejtë. Po të mos ikja ashtu kushedi se ç'do të bëja... E ndieja që kështu ishte më mirë. E ndieja që ai do të më gjente...

po dëshirat e këtij vjeti, që do t'i shqiptohet  
dhe që do t'i përmendur me qëllim. Të gjithë  
njerëzit, që nuk janë të përfunduar me qëllimin  
që i ka bërë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia. Nëse është i lindur që  
do t'i bëjë këtia, nuk mund t'i përmendur  
që do t'i bëjë këtia.

## KËNGA E BUKËS SË RE

“Lidhur një këngë, lidhur një këngë,  
lidhur një këngë, lidhur një këngë,  
lidhur një këngë, lidhur një këngë,  
lidhur një këngë, lidhur një këngë,

Po të shikoje nga një anë e horizontit, agimi i  
ditës së re po vishët vëlon e bardhë si débora. Na-  
ta po mblidhët dalngadalë pelerinën e saj të errët.  
Bardhesia filloi të hynte kudo si një mysafire shu-  
më e dashur për njerëzit. Ajo u tregonte atyre se  
kapur dorë për dore me të ishte lidhur një ditë e  
bukur korriku. një ditë e kulluar si ari. Ajo filloi  
të zbulojë qiellin të i ngjante një pasqyre të stërmadhe,  
konturet e të cilës mund të ravigjëzo-  
heshin vetëm në majat e maleve kaltëroshe.  
Atëherë njerëzit, në gjirin e ëmbël të këtij agimi,  
fillojnë menjëherë punët e tyre. Ja, kooperativistët  
vrapojnë si duhia e veriut për në arat kù gruri ka  
marrë ngjyrë floriri. Të gjithë janë atje, parcelë më  
parcelë. Një kuadrat i madhi është me kallinj buçko

nga shëndeti ka mbetur pa e ndier shijen e draprit të verës. E stërmundon fort etja e të korrurit. Ta-shmë mëngjesi ia ka nisur me një fëshfëritje të lehtë e diç thotë e kërkon me atë fillad joshës.

Fëshfëritja e atij gruri si det, kokërrzat si flori dhe aromja e bukës së re fton jo vetëm kooperativistët, por edhe këdo që ka shpirt dhe ndjenja të shkojë pranë tij. Ai i bën vend atje në arë kujtdo. Këtë ushtarët e dinë mirë. Janë zgjuar herët sot, më përpëra se ditët e tjera. Veshur e ngjeshur për betejën e bukës. Supet e tyre me drapër e pushkë. Flasin e qeshin. Njërit prej tyre i vjen e fejuara sot dhe e ngacmojnë. Ka marrë telegram.

— Asnjë nuk mungon, — u dëgjuat një zë. — Edhe Gazmendi me Spiron kanë ardhë!

— Pse nuk e kanë bërë shërbimin sonte? — pyeti komandanti.

— E kemi bërë, — thanë ata.

Ai u afroa pranë tyre.

— Ju duhet të clodheni. Nuk jeni në gjendje të rrini në këmbë tërë ditën.

— Clodhja më e madhe, shoku komandant, — ia kthëu Gazmendi, — është kur të mbledhim bukën e re. Si tha komisari? Është «alarm». Do të mungonim në në alarm?!

— Mirë. Ai drapri tjeter i kujt është? — pyeti komandanti.

— Imi.

— Të dy të tutë?

— Më dhanë një, shoku komandant, që i lëviz paksa bishti. Thashë mos më lë në baltë, prandaj mora edhe këtë tjetrin.

— Drapérinjtë janë të gjithë të rinj, si të paska

qëlluar ty i prishur?! — tha komandanti. — Lëre, lëre njërin, se mos të humb.

— Mirë po nuk dihet, shoku komandant, që mund t'i dalë zot ndonjëri atje në arë! Dicka kâ ditur edhe ajo vajza e asaj këngës popullore që thotë «*Shkon syzeza në arë me korrë! Me dy drapna për nën dorë!*». S'i dihet, s'i dihet se kush vjen përbri Gazmendit, — tha Spiroja.

Gazmendi buzëqeshi. Atë kohë edhe ushtarët bashkë me komandantin ia dhanë një të qeshure me zë të ulët.

Gazmendi vinte me një gjatësi mesatare si trup dhe nuk shquhej aty në mes të rreshtit. Trupin e kishte të lidhur si trekëndësh. Div nga forca, mjalltë nga goja. Faqet e tij pak të zeshkëta ishin plot shëndet, «t'i bïje njërsë i plastë tjetra». Vetullat e tij, që i përthyeshin andej nga fundi në ballin e gjerë, i jepnin fytyrës një pamje të qetë dhe simpatike, gjë të cilën e shprehnin edhe sytë e tij të kulluar, sytë e tij gri. Uniforma e gjelbër i qëndronte kaq mirë në trup sikur të ishte prej rë me porosi. Shumë i shkonin shakatë, të cilat gjithnjë i përdorte me vend.

Njëherë ishin në qitje. Në pozicion, atje në poligonin e blertë, i erdhë radha Gazmendit. Ai u shtri, ngjeshi fort bërrylat në tokë dhe shtrëngoi kaq shumë pushkën pas supit, sa një qime floku nuk lëvizte. Thua se ishte ngriре aty në dorën e tij. Bëri thep e shqekës bashkë duke e mprehur më së miri syrin. Qëndroi pak çaste pa marrë frymë dhe ia dha me këmbëzën e shkrepjes tre plumba, që «përshëndetën» tabelën. Lugina ku që ndërtuar poligoni përcollë edhe jehonën e krismave të pushkës së Gazmendit. Pasi mori vesh rezultatin, shkoi pranë shkëve.

— Si dole? — pyeti Spiroja, shoku i tij më i ngushtë.

Gazmendi ecte kryeulur.  
— U detyrova t'ia lë pushkën tjétrit pa marrë asgjë me vete.

— Si kështu?  
— Dhjeta, nënta, teta e të gjitha numrât me radhë duken mikroskopikë që afér, e jo më aq larg sa gjuajta unë.

— Si? Po tjetër herë ti s'ke folur kështu, — ia priti një tjetër.

— Çfarë do të thuash me këto fjalë? — pyeti Gazmendi si i nxehur.

— Tjetër herë ke dale shkëlqyeshëm, ja këtë dua të them.

— Qe pra, kësaj radhe syri nuk më kapi as krye, as brinjë, as bisht.

— Ti mos u bëj merak dhë mos u nxeh, Tjetër herë mos e lejo të të bëjë bisht plumbi! Fute zemrën e tabelës në bebe të syrit.

— Zemrën?  
— Po, pra, zemrën në shenjestër të pushkës. Bile po i lutemi komandantit që ta bësh një qitje jashtë radhe. I themi kështu kolektivisht.

— Jo! Nuk dua sot, Do të kemi prapë qitje!  
Këto kujtoi Gazmendi duke parë komandantin.

— Shoku komandant! Ju më mirë ktheñi vetëm Spiron! Ai ka qenë pak i sëmurë mibrëmë.

— Spiro! Hyr në fjetore! — urdhëroi komandanti.

— Shërbimin në vendin tim e bëri Gazmendi, as në punë të mos vete?! Kjo nuk shkon. Unë do të vij pa mijë pa dy. Më besoni, tanë në mëngjes unë

jam shumë mirë. — I thoni Gazmendit të rrijë, se pse ai ka bërë dy herë shërbimin sonte.

— Ç'ke me mua! — iu drejtua Gazmendi, — rregullo, more i shkretë, veten tënde! — dhe vështroi eprorin. — Unë nuk kthehem prapa, shoku komandan, — i tha.

— As unë, — nguli këmbë Spiroja.

Komandanti u largua më një ndjenjë krenarie për ushtarët e tij.

— Spiro! Njëmijë herë të porosita që të mos tregosh për punën e shërbimit! — i foli Gazmendi.

— A e pe se për pak qe duke më ndalur komandan-ti këtu?

— Ty të vjen e fejuara, dhe ti dashke të më lësh mua në repart. Do t'i them komandanit... Ajo nuk vjen për mua, po për ty. Rri e prite! Ja, t'i themi...

— Spirooo! — iu kanos Gazmendi në shenjë qor-timi duke ia ndërprerë fjalën.

Dhe erdhi heshtja. Zunë vend secili në rrresh-tin e tij. U dha urdhri i nisjes. Në njëshkolonë filloj marshimi. Në krye ishin komisari dhe koman-danti.

Porsa arritën u bë shpejt e shpejt organizimi i punës. Parcelsa e madhe e pakorrur ndjeu mbi tabani e saj se dikush qëndronte mbi të. Kallintë e gruriit me fytyrë nga njëri-tjetri po shpërndanin si-hariqin e të korrrurit. Puna filloj. Dëgjohej fëshfë-ritja e draprit si një melodi e lehtë këngë. Ushtarët hidhnin vallen e korrijës krah për krah me kuadrot. Dielli nxori një vetull tutje në një anë malit dhe në anën tjetër hodhi me përkëdhelje rrezet e tijë. Ara-

ve me grurë u ishte ndryshuar pamja. Ishte ndezur një mozaik ngjyrash në fushë.

— Në arën dukën edhe katër brigada me kooperativistë. U printe kryetari. Fill pas tyre fusha u mbush me cicërimat e vogëlushëve. Kryetari, i gëzuar së tepërmë për këto forca të «pazbuluara», ferkonte vazhdimisht duart, e për një çast nuk po u besonte syve. Turma oshëtinte si valë deti.

— Ouu, ç'paskeni punuar kështu, o komisar! — foli kryetari me atë lumturinë që i shndriste në sy. Komisari drejtoi trupin, lidhi dorezën e grurit të korrur dhe e futi në tufë. Kur erdhi kryetari, ai u përshtendet me të dhe iu përgjigj:

— Nuk është punë e komisarit kjo, joo! Është puna e djemve tanë, — dhe me dorë tregoi ushtarët.

— Më ju lumtë, o çuna! Rrofshi e qofshi e gjëzofshi gjithmonë të ritë tuaj! — uroi kryetari me zë të lartë dhe i tha komisarit: — Tani ushtarët le ta ndërpresin punën, se do ta përfundoj me forcat e mia. Ju falëminderit shumë.

— Pa dale ta dëgjojmë zërin e masës ç'thotë! Ata pyet, jo mua!

Komisari bëri me dorë të afroheshin ushtarët. Pak e nga pak u mblohdhën të gjithë.

— Çuna, filloi kryetari. — Në emër të kryesisë ju falënderoj nxehtësisht. Tani erdhën forcatona, prandaj duhet ta lini ipunën. Gati gjashtëdhjetë përqind të sipërfaqes së parcelës e keni korrur. Edhe njëherë ju them: Ju lumtë! A jeni dakord me propozimin tim, more djem?

— Jooo! — buçiten njëherazi, e prerë zërat e ushtarëve, — do të jetë!

— Siii? — ia bëri kryetari.

— Jo, more shoku kryetar, jo dhë jó! — S'iudurua pa folur Gazmendit. — Jemi njerëz të tillë ne që çdo punë, kur e nisim, e shpiem gjer në fund. Ju, o kryetar, si i themi ne andej nga Veriu, «këmbët e lehta e faqja e bardhë». Shkonibëni ndonjë punë tjeter të ngutshme. Parcelës i kemi dalë përzot vetëm ne, apo jo, more shokë? — iu drejtua ai ushtarëve të tjerë.

Ushtarët i miratuan fjalët e Gazmendit me fytyra të qeshura. Ai ia bëri me kokë kryetarit të mos vazhdonte më tej, por kryetari nuk bindesh.

Në fund e mbylli komisari «sherrin», kur e pa se kryetari po është gjatë.

— Ti e sheh, or kryetar, së nuk dëgjojnë. Coji kooperativistët në ndonjë punë tjeter, apo s'ke punë?

— Oj, thotë s'ke punë në këtë valë fushatë! Edhe natën me hënë po punojmë e nuk po ua dallim dot, aq shumë punë kemi! Më dhatë një ndihmë të madhe. Punë e mbarë pra, çuna! — i dha dorën komisarit dhe iku.

— Ditën e mirë, shoku kryetar! — e përshëndetën ata.

Edhe kooperativistët përshëndetën me dorë dhe u larguan. Të gjithë u shpërndanë në vendet e tyre. Puna filloi më me vrull e ritëm luftarak. Dikur nisi kënga e bukës së re. Sulm nga të gjitha anët. Vrull i papërbajtur, Kallinjtë e grurit që nuk i kapte mirë drapri, i mblidhnin fëmijët prapa, pas «xhaxhi ushtarit» si i thonin ata.

Drapër për drapër ecnin Gazmendi dhe Spiroja.

— Gazmend, të kërkojnë atje në krye të arës, — i tha një ushtar.

Të dy drejtuan trupin. Në bregoren e kanalit qëndronte, e ulur një vajzë. Spiros nuk iu durua pa folur.

— Ohoho! Ohoho! Ja, tani, mor jahu, shko e dil në raport para të fejuarës!

Buzëqeshën dhe pastaj Gazmendi, pasi mori leje, u nis.

Arlinda, me një trup të hollë si më e mira belkëputurë, me një fytyrë pak të rrumbullakët, ku diktójë gjithmonë një émbëlsi që buronte nga sytë e saj të kaltër, ishte ulur në bregoren e kanalit. Ajo shkoqi midis pëllëmbëve dy-tre kallëza grurë dhe syri iu ngop me shëndetin e kokërrzave të tij, që nën rrezet e ngrohta të diellit ngjanin me kokrra xhevahiri. Mori disa prej tyre i futi në gojë e i përtypi. Ato iu dukën të émbla si sheqeri. Duke u përtypur lozte me gërshtetin e saj të gjatë dhe kundronte fjongon e verdhë që ishte si fluturzë, e cila i shkonte pér bukuri bishtalecit të drëdhur me kujdes. Në këto çaste Arlinda dëgjoi zhurmë hapash. Brofi në këmbë e pa Gazmenden që s'po ia ndante sytë. Në fotografji, me rrobet ushtarake, i fejuari i ishte dukur si tjetër njeri. Tani para syve kishte Gazmenden e saj të dikurshëm, po më i gjallë, më i shëndetshëm. Ajo i zgjati dorën dhe u skuq kur pa sa shpejt e shtrëngoi Gazmendi me dy duart e tij. Në atë shtrëngim duarsh qëndronin të gjitha ngjyrat e bukura të asaj dite, por më e ndezura, më e dashura, ngjyra e punës u paraprinte të tjerave. Kjo i ra vajzës përnjéherësh në sy, Vlonte filladi i grunoreve. Zienin zërat gaz-

morë të të rinjvet ushtarë. Vogëlushët ngjanin me zogjtë e praniverës. Gruri ishte luletrëndelinë, ishte mjaltë, ishte bukë.

— Isha në report — i tha "ajo më atë zërin e butë, që të bënte përvete. — Atë shokët e tu më thanë se je këtu. Unë të bëra telegram dhe nuk më kë përitur, ë?"

— Unë të prisja, — bëri shaka Gazmendi, — po ç'të bëja?! Ky gruri nuk donte të të prisja. «Lëre të fejuarën, — më tha, — se vjen e të gjen ajo ku-do që të jesh».

Flisnin e nuk ia ndanin sytë njëri-tjetrit.

— Veprova mirë apo...? — e pyeti Gazmendi pas shakasë që bëri.

Dhe ajo, gjithë me buzë në gaz, i tha:

— Shumë mirë ke vepruar. Ta them singarisht. Ku ka takim më të bukur se këtu, Gazi im!

— Arlinda! Eja të të njoh me shokët. Do të të njoh pastaj edhe me një tjetër. Atë ta them me gjë a gjëzë.

Dy të rintë shkuan pranë Spiros. Arlinda u pëershëndet me të. Pastaj Gazmendi e pyeti:

— Si të duket këtu, Arlinda?

— Ju paskam zili! — qeshi Arlinda. Të gjithë ishin të gjëzuar dhe e kishin vënë vajzën në mes. Ajo fliste lirshëm me ta dhe vështronte grurin. Sytë i vajtën te drapri i ri që qëndronte mbi një piramidëz gruri.

«Drapërinjtë i kanë në dorë të gjithë, po ky drapër ç'ruan këtu?»

Tek po mendonte vajza kështu, Gazmendi i tha:

— Tani i erdhi radha gjë a gjëzës...

Duke folur ai v  shtroi nga drapri.

— Mos ma thuaj, — thirri Arlinda. — Mos ma  
thuaj! Ai drapér pa zot atje eshtë marrë pér mua.  
Ai më ka pritur mua.

Si tha këto, vrapoi e mori draprin. Filloi edhe ajo të punonte me shokët e të fejuarit. Tek lëvizte duart me aq shkathësi e gjëzim, Gazmendit i dukej sikur nuk punonte po këndonte, sikur këndonte një këngë pér bukën e re...

shumë e shpejtë, qëndrueshme, e caktuar me vrapin e kafshës së pëllumbave, që i përcaktojnë këtë gjë. Në këtë rast, shumë i lindur është që vrapit e kafshës së pëllumbave të përcaktojë këtë gjë. Në këtë rast, shumë i lindur është që vrapit e kafshës së pëllumbave të përcaktojë këtë gjë.

Shumë e shpejtë, qëndrueshme, e caktuar me vrapin e kafshës së pëllumbave, që i përcaktojnë këtë gjë. Në këtë rast, shumë i lindur është që vrapit e kafshës së pëllumbave të përcaktojë këtë gjë. Në këtë rast, shumë i lindur është që vrapit e kafshës së pëllumbave të përcaktojë këtë gjë.

## E PAPRITURA

Artikoli i 3<sup>rt</sup> Shtetit, Dita 199, 2011  
Artikoli i 3<sup>rt</sup> Shtetit, Dita 199, 2011  
Artikoli i 3<sup>rt</sup> Shtetit, Dita 199, 2011  
Artikoli i 3<sup>rt</sup> Shtetit, Dita 199, 2011

Gatuesja e brumit kishte lëshuar atë zhurmën e saj monotone në furrën e bukës. Elektromotori i saj fëshfërinte si një erë e lehtë vjeshte. Përzierësi, që të kujtonte nockën e një elefanti të vogël, tundte brumin.

Aroma e mirë e bukës së pjekur ndihej kudo në furre. Aty brumbullonte edhe zjarri bubulak i saj.

Shpresa, furrtarja e turnit, që e kishte mbuluar fustanin me një përparëse të bardhë e mjaft të pastër, i fuste herë pas here krahët në kazan dhe ndihmonte përzierësin, që të shpejtonte ritmin e rrotullimit. Shoku i saj vajiste tavat.

Në furre ventë e vinte edhe një tjetër. Ai nuk punonte. Para pak çastesh ishte brigadier, tanë nuk ishte më. Nuk i vinte mirë që po e linte atë vend pune. Bile një përrua i rrëmbyeshëm mërzie e ki-

shte vënë përpara. Ai buronte me forcë e vrull, aty te zëri i asaj që propozoi për shkurtim. Para syve e kishte dhe e shikonë me bishtin e syrit.

Zhurma e gatueses së brumit u mek. Përzierësi  
~~e uli bëndën me ngadalë, sikur nuk i erdhi mirë që i ra aq poshtë. Paq e në brumë! Ishte mësuar ai ta tundte brumin orë e çast.~~

«Tani — tha me vete ish-brigadieri, — shqyr që erdhi ora. Ta shikoj të paktën sot si i bie kurri-zi për tokë, duke gatuar brumë. Jepi, moj, ho, ho, ho!»

Shikonte tej e tej koka e tij lart, vështrimi di-ku. I téri kishte qëndruar në një pozicion mospër- fillës për atë që ndodhi.

— A ju ka lajmëruar elektricisti, o Xhemal? — pyeti furrtari.

— Përse? — pyeti brigadieri i hequr.

— Se sot ka remont linje.

— E di shoqja, — tha me ironi për kunatën.

— Lajmëroni për dyfishimin e turnit. Tensioni nuk vjen gjer në mbrëmje.

— Unë s'bëj asgjë sot, përvèç dorëzimeve!

Luajti duart. Sikur desh të thoshte me ato «S'ke ç'ti bësh! Po të isha brigadier, për dy minuta turni do të ishte këtu. Tani gjejeni vetë, sidomos ajo».

— Bëje për hatrin e kunatës, — tha Shpresa.

«Ç'kunatë je ti, moj! Propozon ti për mua si i tepërt në këtë vend!? E ç'më pandeh mua, sylesh, qoftë gangull, apo mullar bari, që të shkoj e të sjell turnin? Këtu dua t'i shoh djersët e tua palë-palë. Ta kesh këtë prej meje».

Dhe, me këto mendime Xhemali e shikoi vën-gër. Furrtarja e kuptoi mirë se q'thanë ato sytë e Xhemalit!

Pastaj Xhemali mendoi se me Shpresën, në praninë e furrtarit tjetër, duhej folur me dorashka. Të ishte vetëm për vetëm me të gjithë dufin, zemërimin e stuhinë e atyre fjalëve që mbante benda do t'ia zbrazte me egërsinë e atyre ditëve të dimrit. Nga ato ditë ku ka ngrija e asar, me re që sto rrojnë qellin, me të versulura shiu e rrëveshi të ftohtë, që as tokë mos t'i mbaje! Nuk pat rast e atëherë u përgjigj pa ulur egërsinë e shikimit, (vetëm në sytë e tij ishte dita e dimrit);

— Në punë, shoqja Shpresë, dhe sidomos në mbledhje, nuk ka kunat e kunatë, por jemi të gjithë të barabartë.

Xhemali kroi zverkun e trashë, Pastaj ferkoi gushën e dhjamur rrathë-rrathë. Po të, kishte qëlluar pranë ndonjë shok besnik, nga halli do t'ia kishte luajtur syrin e majtë kokërrdhok nja një-qind herë. Fytyrës së Shpresës i ra një çehre e rëndë.

— Për mua hap mos luaj, — u përgjigj ajo. — Por shiko ama se puna po çalon.

— Pikë përgjegjësie nuk mbaj! Për këtë punë as gëk as mëk, nuk dua të ta dëgjoj zërin. More vesh?

Shpresa e shikoi si fshihej inati pas atyre fjalëve. Shikoi orën e murit. Po afrohej mesi i ditës. Aty nga ora e dy e pasdrekes hynte furra e dytë, po të vazhdonte punën gatuesja e brumit. Por sot ishin pa të. Si t'ia bënин? As turni tjetër nuk lajmërohej. Si t'ia bënин? Atëherë Shpresa përveshi mëngët dhe ia dha përzierjes së brumit si të ishte në punë gatuesja.

«Ti ke nevojë për kullim të ndërgjegjes, o Xhemal, ashtu si kullohet ara për të rritur gru-

rin e shëndetshëm. Të duhet lopata për kullim patjetër ty».

Kështu mendonte Shpresa kur në derë u dha burri i vet. Ajo u mundua t'i jepte shkëlqim fytyrës. S'donte ta dinte i shoqi se çfarë kishte ndodhur. Më mirë të shtrohej biseda në shtëpi, urtë e butë. Në furrë s'ishte vendi për llafe. Duhej punë aty.

«Po trëgon shumë fytyra e Xhemalit», tha me vete.

— C'ke kështu? — e pyeti i vëllai Xhemalin.

— Pyet më mirë tët shoqe — bërtiti ai kur pa se furrtari iku për të lajmëruar që mungonte korenti.

— C'ka? — iu drejtua Shpresës.

— E kanë hequr si brigadier.

— Kush?

— Kolektivi.

— Génjen. Ti më hoqe!

— Unë vëtëm sa propozova...

— E dëgjon!?

— Xhemal! — i tha Shpresa me të butë, — ulezérin.

— Më thuaj më mirë shejtan, — i ndërhyri ai,

— dreq, çfarë të duash, por emrin tim mos më zër me gojë.

Filloi hakmarrja zemërake e Xhemalit.

— Dua të më kuptosh! Më mirë të filloja nga ti, e pastaj për të tjerët.

Vështroi të shoqin. Ai ia pasoi:

— Si kështu, Xhemal, për këtë punë je bërë flakë në fytyrë? Mor vëlla, me tapi nuk e ke vendin e punës. Sot brigadier, nesër bujk. Edhe më i nnderuar...

— Si, edhe ti kundër!?

— Jo ndaj teje, por ndaj vendit tënd. Ime sho-

qe bëri mirë që filloj niga vatra jonë. Do të fliste dikush në atë mbledhje: «Moj ti! Si të rrjedhkan ulluk fjalët pér tē tjerët! Eh, moj xhanë! Çoje kokën pak lart dheshtik trarin që tē ka zënë çatinë. Pastaj fol!»

— Kësaj nuk i duhej tē fliste. Askujt tjetër s'i kishte rënë në mend që tē propozonë!

— Në mos sot, nesër!

— Kjo, o vëllai, eshtë e papritur.

— E papritur, lum vëllai, po pér mirë ka pér tē dalë.

— Domosdo ti i del zot sat shoqjeje!

— Jo asaj, por së drejtës!

— A, këshfu qenka puna! Atëherë ti jeto me drejtësinë e gruas sate, kurse vëllait tënd ke pér t'i parë shpinën.

— Çfarë flet ashtu, Xhemal? Fjala e fundit tē ka dalë e para! Pse nxitohesh?!

— Aspak.

— Xhemal! — u dëgjuja zëri i Shpresës. — Më thuaj më mirë «shporrë prej tim vëllai», se sa tē keqesh me tē. Ai s'të ka bërë asgjë. Me mua, me mua fol, dhe në rast se e shikon tē arsyeshme, ngrijë zérin, gjer ku nuk dëgjohet.

— S'ta pata pér borxha tē flisje ashtu, — tha me gjysmë zëri Xhemali.

— Mirë, o Xhemal, po në hak tē huaj unë nuk hyj.

— Atëherë tē mbaka haku im?!

— Haku yt eshtë dhe imi! — tha Shpresa. — Et Trang... Trang... Trang... — herë dha krismë ora e murit.

— Dang... Dang... Dang... iu bë sikur po i binin me çekiç kokës së tij.

Atéherë Xhemali doli fluturim pérjashta. I ra një ndjenjë pendimi e thellë pér fjalët që i tha të vëllait. «Lodhet ai në punë atje, duke luajtur lopatën, e lodh edhe unë këtu me shamatë. Aq më tē pér them edhe fjalë që nuk më shkojnë. Pu! Pu! Pu!»

Dhe i ra ballit me dorë.

Shpresa e vështroi të shoqin. Ëmbëlsia e shikimit thoshte: «Mos u bëj merak ti! Në më thëngin Shpresë, do ta rregulloj këtë punë».

Ajo përçolli të shoqin dhe hyri brenda. Filloi punën.

— Ku je, moj Shpresë, — dëgjoi një zë pas shpine. — Ty të lumtë, ia ke çuar si burrneshat. Kësi njerëzish duam ne.

— «Ah, sikur të jetë zëri i Xhemalit». Në ato çaste kjo ishte dëshira e saj e ngutshme.

Ajo u soll prapa. Pa sekretarin e Partisë dhe Xhemalin.

Sekretari ia shtrëngoi dorën me ngrohtësi. Diktoi se fytyra e Shpresës nuk e kishte shkëlqimin e atyre ditëve të tjera. Xhemali ishte hundë e buzë... Diçka nuk shkonte këtu. Sekretari përfshiu furren me një sy të ftohtë, që erdh e u gjallërua pak nga pak. U kthyesh nga Xhemali dhe e pyeti pse nuk e kishte dyfishuar turnin.

— Duhet të jesh njoftuar që sot nuk ka drita... Xhemali ngriti supet dhe mendoi se e hodhi me aq.

— Brumi nuk bëhet duke ngritur supet, po duke e përzier me dorë, shoku Xhemal!.. Mos do të hanë njerëzit te psipet tuaja bosh?

— Mos u bëj merak, shoku sekretar. E nisa furrtarin të lajmërojë turnin tjetër...

— Rri, ti, rri, moj Shpresë, — tha sekretari, që e kuptoi se ajo donte ta zbutë. — Rri... Xhemalini e gjeta tek ikte në shtëpi... S'ka korent dhe, o burra, mbathja! Apo është ajo puna e brigadierit?!

— Unë kam për të bërë vetëm dorëzimet, shokët sekretar. Do të kthehesha pas dite.

— Aha... Emora vesh. Nuk je më brigadier dhe aq të bën në bëhet bukë apo nuk bëhet!

Tundi, kokën me një ndjenjë shqetësimi, dherë mërzie dhe hoqi xhaketën.

— Këtu kam punuar dhe unë dikur, o Xhemal, e atëherë nuk kishim as përzierëse brumi, as korent. Kishim, vetëm këto... — sekretari tregoi mustaku, kujt e fryrë nënë këmishë. Tani ai nuk ishte i zëmëruar, përmë tepër dukej i kënaqur që iu dha rasti të kujtojë kohën kur punonët në furrë. I futi duart në brumë me kënaqësi dhe si e pa Xhemalin në sy, vazhdoi:

— Kështu punoja një kohë dhe nuk punoja, keq. Më thanë se ishte e nevojshme të kaloja në fushë dhe mora lopatën... Do të punojmë ku të ketë nevojë, o Xhemal. Po vij nga mbledhja... Një nga rojet foli bukur. «E di si është puna e burokratit?

— tha ai. — Është si puna e miut që kërkon vrimë. E ndjek dhe e nuhat atë vrimë gjithë kohën dhe nuk e lëshon me dëshirë, sepse ka bërë çmim përtatë gjetur. Përtypet miu burokrat dhe rri urtë e butë aty! Se e ka të qartë ai që po e kullot badiava, prandaj, vetëm hesht, rri rehat e nuk ndihet për së gjallë. Doni shembuj ju? Jua japunë. Ka p.sh. në arë punë për dy vjetë, brigadieri dërgon tre, njëri e kullot qyl. Atje në shërbimet e artizanatit, — tha ai, — ka një brigadier. Përgdo reparti ka dhe një

përgjegjës. Këta përgjegjësit a nuk mund të bëjnë punën e brigadierit! Ka dy roje sektori ditën, shumë mirë mund ta bëjë njëri. Unë, që të mos mbetem një mi i tillë, dua të dal nga kjo skutë ku kam hyrë. Sa më parë!» Kështu, o Xhemal! E filloi nga vetja luftën ai, si nuk ka më mirë, si nuk ka më bukur. U tregua i pjekur.

«Dhe i luajtur nga mendtë!» murmuriti nëpër buzë ish-brigadieri, i mbështetur pas tavolinës. Ai që kishte diskutuar kështu ishte i vëllai, i shoqi i Shpresës. Pastaj iu drejtua sekretarit:

— Jo i pjekur, por i mençur, shoku sekretar. I ka rënë hilesë ai. Ka thënë me vete, sa të më heqin të tjerët, më mirë po prопозој unë. Ka dashur të paraqitet si lugë e larë!

— Ju jeni shumë i cekët, shoku Xhemal! Atëherë sipas teje edhe Shpresa, që prопозoi për ty, e tillë qenka?

— Jo, për atë nuk them asgjë. Ajo ka vepruar drejt.

Xhemali nuk kishte si të thoshte ndryshe në sy të sekretarit.

— Ato që the, — ia priti sekretari, — janë vëtëm fjalë goje, por jo fjalë zemre. Po të ishin të vërteta ato fjalë, nuk do ti mbaje mëri Shpresës.

— Jo, më vjen keq, shoku sekretar, që më thoni ashtu. Pyeteni, po deshët, nëse i kam rënë në qafë.

— S'kam nevojë ta pyes. Përgjigjen e gjeta në fytyrën e saj.

Sekretari gatuante brumin si një furrtar i mire dhe pasi mbushte tavat e bukës i shtynte në grykën e furrës me lopatën e gjatë.

— Këtu s'është koha që ta zgjatim, se ja furra! Pasdreke duku andej nga zyra. Je edhe më i qetë.

Atje t'i shoshitim punët, — hodhi sytë nga furrtarja që punonte më vrull. — Shpresë, moj nuse! Më ngadalë, moj trime, çështë ai vrull ashtu?

Vrulli i saj ishte i papërmbytshëm. Bëshkë me sekretarin, u pikonin djersët pikë-pikë.

Ora po shkonte dy. Sekretari përcillte bukët në furre. Furra e parë hyri shpejt, sikur të ishte në punë gatuesja e brumit. U desh stërmundim vëçse! Këtë e ndienin, por gjëzimi ua mundi lodhjen, sepse rezerva e brumit nuk u pre. Filloi e dyta furre. Sekretarin e lajmëruan përfnjë punë të ngutshme.

— Mbëta vetëm, — tha Shpresat pa u lëshuar.

— Jo! Jo, moj nuse! Do të jetë Xhemali.

— Nuk e ndiej veten mirë, se do të kisha punuar me kohë.

Ndërgjegjja u rëndua akoma më tepër.

— Si të duash. Që je pak i sëmurë, këtë e pashë, në fillim, prandaj s'të bëra zë!

«Pak i sëmurë». Xhemalit i dogji sikur të kish prekur një urë zjarri me gjuhë. E ndiente veten shumë të shqetësuar, prandaj doli menjëherë ja shtë, sapo iku sekretari.

Ai hynte dhe delte. Delte dhe hynte. Brenda s'i bëhej të rrinte, por edhe jashtë nuk kishte qetësi, se i bëhej sikur merrte turpin me vete. Më dysh. Edhe ndërgjegjja në dyluftim. «Kunata mbësë s'ka faj, se koi nuk do t'i thoshin të tjerët»: «Të lumtë». Edhe sekretari nuk ia shtrëngon dorën askujt përtë keq. As im vëlla, po të ish në gabim, nuk do ta përkrahte fjalën e saj. E njoh, unë atë. Hej, belal Mos bie mbi veten time kamxhiku i gabimit. Të kërkoj falje!... Falje ndaj Shpresës?... Jo... Po duhet pra!

— Përsëri hyr e dil nga furra. «Si tha sekretari? Burokrati si mi?! Unë i tillë? Xhemal miu unë?! Jo! ... Jo!... Duhet t'i shtrohem punës!»

Hyri brenda. U step. Gjuha iu rëndua. S'i nën-shtrohej komandimit të trurit. Edhe goja iu mbyll, se ia kyçi sedra. Doli prapë jashtë.

Mendoi Shpresa:

— Ta kuptova qëllimin, o Xhemal! Kërkon të vish këtu, në këtë truall ku thashë unë, ku thanë sekretari, im shoq, ku thanë të gjithë. E ke të qartë ti, o Xhemal, se ky truall është, truall punë, i fortë, i paçarë, i pashmangshëm. Kërkon t'i lësh sorollatjet poshtë, e lartëti, atë taban prej druje të kalbur! Të shikoj, unë, të shikoj, se kot nuk hyn edel; Eh, kjo isedra! Do ta thyej unë tanë... Me se?!... Ah, more Xhemal, për pak harrova se urdhrat e përgjegjësit të sektorit, kur kanë qenë në dobi të punës, ti i ke zbatuar një për një. E gjeta, e gjeta...

Në këto kështu, erdhi furritari tjetër dhe Shpreza gati sa nuk brohoriti kur e pa.

Ajo ia tregoi një nga një mendimet e veta shokut të punës, dhe e këshilloi të vepronë sipas porosisë së saj, apo Xhemali të hynte brenda.

— Xhemal, — i tha ai porsa erdhi, — isha te përgjegjësi i sektorit.

— Çfarë të tha? — pyeti njerëzisht Xhemali.

— T'i bësh dörëzimet Shpresës dhe të punosh në vendin e saj. Ajo do të ndajë bukën sonte.

Xhemali nuk e zgjati. Atë fjalë kishte pritur. Madje, në sy të Shpresës, ky ishte urdhër e urdhrit s'i bëhej fjalë. Filloi menjëherë punën. Shkoi në përzierjen aty ku kishte më shumë lodhje.

«T'i tregoj Shpresës se edhe unë ia them punës së vështirë» mendoi.

Shpresa bëri sikur merrej me ndarjen e bukës, por me bisht të syrit vështronte Xhemalin.

Ai po djersinte i terti. Krahët e tij ishin këputur sikur t'u kishe rënë me shkop, pa pushim. Mundohei të punonte shpejt e shpejt, por kurrë s'ia arrirëtë të punonte si sekretari e si ai furtari tjetër, pa le si Shpresa jo se jo.

Hahej me veten:

«Hë, o Xhemal, ku është më mirë, atje ku ishe apo këtu? Atje, atje, se këtu je bërë që as b... e tua të mos i lidhësh! S'të dija për kaq të ligsht, o Xhemo, me tërë atë trup që ke! Dy herë i mbllaqite duart në brumë! më shumë të përzjeu ai ty, se ti atë. S'ka si ndodh ndryshe, kur nuk ke bërë punë krahu e je marrë me punë të lehtë.»

Vështroi kunatën me sy të mirë.

«Më rrofsh, moj kunatë. Më nxore në rrugën e punës, he ty ta lumsha! Jepi, jepi Xhemo, ngjeshi duart në brumë!»

Përsëri i jepte me sa fuqi kish. Po hë de, nuk mundej. Shpresa i erdhi në ndihmë.

Mos, moj nuse! Rri rehat, moj kunatë! Koka ime këtu bindet, këtu!

Ajo buzëqeshte dhe punonte. Dritat elektrike ranë mbi fufërë. U ndriçua çdo gjë, por shkëlqimin më të ndritur e mori Xhemalin.

## PASQYRA E LËNDËS

Në rrugën «Çimisko» të Selanikut .....	3
Gjarpri i unorit .....	12
Amanëti i partizanit .....	21
Ditët e njohjes .....	32
Kënga e bukës së re .....	45
E papritura' .....	54

Gjoni, Ç,

Në rrugën «Çimisko» të Selanikut,  
Tregime. T.; «Naim Frashëri», 1979.

... f

B-ka të mëdha dhe

B-ka të vogla: 891: 983-32

Gj 92

Tirazhi 4.000 kopje

Format 70x100/32 Stash: 2204-72

---

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1979

